

YLBER MARKU

Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë
ylbermarku@protonmail.com

**TERRENI I NJË PARTNERITETI: MODELI SOCIALIST KINEZ
DHE RRUGËTIMI EKONOMIK I SHQIPËRISË NË PERIUdhËN
E HERSHME TË LUFTËS SË FTOHTË****Abstrakt:**

Bazuar kryesisht në burimet arkivore shqiptare, ky artikull eksploron implikimet e bashkëpunimit ekonomik të Shqipërisë me Kinën gjatë fundit të viteve 1950 dhe fillimit të viteve 1960. Punimi tregon se në vendimet e Shqipërisë për ndryshimin e aleancave, përlogaritjet ekonomike kanë qenë po aq të rëndësishme sa konsideratat politike. Artikulli argumenton se vënia e theksit mbi industrializimin e rëndë, mobilizimin e masave dhe parimin e mbështetjes në forcat e veta, nga ana e Kinës, ishte tërheqës për planet ekonomike afatgjata të udhëheqësve shqiptarë. Ky qëndrim u përforcua edhe më shumë pasi ndarja e punës në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER) e la Shqipërinë në skajet e integritimit ekonomik të bllokut sovjetik evropian, duke e zhvendosur atë në një zhvillim të bazuar në bujqësi. Artikulli gjithashtu argumenton se, megjithëse nuk pati një transferim thelbësor teknologjik midis Kinës dhe Shqipërisë gjatë viteve 1950, ato vite shërbyen për Shqipërinë si një periudhë studimi i sistemit socialist kinez, i cili përfundimisht u përshtatej synimeve politike dhe ekonomike të liderëve shqiptarë më shumë se ai sovjetik. Marrëdhëniet ekonomike me Kinën hapën rrugë të reja tregtare për Shqipërinë, duke e lidhur potencialisht ekonominë e Shqipërisë me tregje të reja dhe me flukset ndërkombëtare të mallrave. Megjithatë, këto mundësi mbetën plotësisht të pashfrytëzuara për shkak të mangësive ekonomike të vetë Shqipërisë, kapaciteteve të kufizuara industriale dhe infrastrukturës së dobët.

Fjalë kyçe:

Ndarja kino-sovjetike, Kinë, Shqipëri, shkëmbime ekonomike.

Hyrje

Disa studime në vitet e fundit kanë nxjerrë në pah kompleksitetin e marrëdhënieve gjatë viteve 1950 midis Kinës dhe Europës Lindore. Punime të tilla kanë kontribuar që ndërveprimet kino-europiane të shihen jo si të varura nga marrëdhëniet kino-sovjetike, por në kuadrin e një logjike të vetën të pavarur.¹ Shqipëria është një rast i veçantë ndër vendet e Europës Lindore. Ekonomikisht e dobët, me industri të rëndë gati inekzistente, dhe me shumicën e popullsisë që jetonte në zonat rurale, pas Luftës së Dytë Botërore vendi ishte pothuajse tërësisht i varur nga ndihma e huaj, e ardhur nga vende të tjera socialiste.

Ekzistojnë dy karakteristika kryesore të peizazhit ekonomik të Shqipërisë pas çlirimit. *Së pari*, ndryshimi i aleancave në periudhën e hershme të Luftës së Ftohtë shkaktoi edhe ndryshime në ndihmën ekonomike: deri në vitin 1948 nën patronazhin e Jugosllavisë; ndërmjet viteve 1949 dhe 1960 u mor një ndihmë e konsiderueshme ekonomike nga Bashkimi Sovjetik; dhe së fundi nga fillimi i viteve 1960, si aleati më i afërt evropian i Pekinit.² *Së dyti*, megjithëse si aleate e Moskës dhe anëtare e KNER-it (Këshilli për Ndihmën Ekonomike Reciproke) Shqipëria mori ndihmë të madhe gjatë viteve 1950 nga blloku sovjetik, ndarja e punës në kuadrin e KNER-it e projektonte Shqipërinë si një vend kryesisht bujqësor brenda Kampit Komunist, dhe përpjekjet sovjetike për të integruar më tej ekonominë e Europës Lindore ishin në kontrast me planet ekonomike të udhëheqësve komunistë shqiptarë.³ Megjithatë, marrëdhëniet ekonomike me bllokun sovjetik në Europë e ekspozuan Shqipërinë ndaj modelit sovjetik poststalinist të përparimit socialist. Elidor Mëhilli ka theksuar rëndësinë e kulturës materiale që u zhvillua në

¹ Janick Marina Schaufelbuehl, Marco Wyss, and Valeria Zanier (eds.), *Europe and China in the Cold War. Exchanges Beyond the Bloc Logic and the Sino-Soviet Split* (Leiden, Boston: Brill, 2019), 175-235; shih gjithashtu Jan Zofka, Péter Vámos & Sören Urbansky (eds.), “Beyond the Kremlin’s reach? Eastern Europe and China in the Cold War era”, special issue, *Cold War History*, vol. 18, no. 3 (2018).

² Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao. Albania and the Socialist World* (Ithaka and London: Cornell University Press, 2017).

³ Besnik Pula, *Globalization Under & After Socialism. The Evolution of Transnational Capital in Central and Eastern Europe* (Stanford, CA: Stanford University Press, 2018), 38-40. Për KNER-in shih gjithashtu Giuseppe Schiavone, *The Institutions of Comecon* (London and Basingstoke: The Macmillan Press, 1981).

Shqipëri gjatë viteve 1950, për shkak të shkëmbimeve intensive ekonomike me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Europës Lindore.⁴ Ai ka treguar, ndër të tjera, se ndikimi kulturor dhe material sovjetik në Shqipëri i mbijetoi përfundimit të aleancës së Tiranës me Moskën.⁵ Kjo ndihmon për të shpjeguar disa nga modelet në marrëdhëniet që regjimi shqiptar vendosi më pas me Kinën.

Ky artikull argumenton se megjithëse gjatë viteve 1950 nuk kishte një transferim thelbësor teknologjik midis Kinës dhe Shqipërisë, kjo periudhë hodhi themelet e bashkëpunimit ekonomik që do të pasonte në vitet 1960, gjatë të cilit ndihma e Kinës çoi në një proces masiv ndërtimi në Shqipëri, me zbatimin e më shumë se njëqind projekteve ekonomike, duke përfshirë dhjetëra projekte në industrinë e rëndë. Për më tepër, artikulli argumenton se marrëdhëniet e pastabilizuara të Shqipërisë me aleatët e saj si pasojë e procesit të destalinizimit – proces që nuk kishte pasur mbështetje në Shqipëri – dhe ngjarjet në Europën Lindore më 1956 e shtynë atë drejt kërkimit të modeleve të reja të ndërtimit socialist, duke u angazhuar më shumë brenda Kampit Socialist me ato vende, siç ishte Kina, të cilat kishin njëfarë autonomie nga Moska dhe ishin të etura për të ofruar modele të ndryshme – dhe mund të thuhet politikisht të pareformuara – të socializmit.⁶ Në të vërtetë, reformizmi i Nikita Hrushovit minoi pozitën e liderit komunist shqiptar Enver Hoxha në një kohë kur kulti i tij i personalitetit po përforcohej në të gjithë vendin. Artikulli argumenton gjithashtu, se marrëdhëniet e ngushta të Shqipërisë me Kinën lehtësuan lidhjet e shkëmbimeve kino-shqiptare me botën e jashtme, duke ndërlidhur këto flukse me rrugët tregtare dhe logjistikën në shkallë ndërkombëtare, duke sjellë ritransferime të teknologjisë brenda

⁴ Mëhilli, *From Stalin to Mao*; Elidor Mëhilli, “Socialist Encounters. Albania and the Transnational Eastern Bloc in the 1950s”, in *Cold War Crossings. International Travel and Exchange across the Soviet Bloc, 1940s – 1960s*, edited by Patryk Babiracki and Kenyon Zimmer, Introduction by Vladislav Zubok, Arlington (Texas: University of Texas at Arlington, Texas A&M Press, 2014), 107-133; Graham H. Roberts (eds.), *Material Culture in Russia and the USSR: Things, Values, Identities* (London and New York: Bloomsbury Academic, 2017).

⁵ Elidor Mëhilli, “Globalized Socialism, Nationalized Time: Soviet Films, Albanian Subjects, and Chinese Audiences across the Sino-Soviet Split”, *Slavic Review*, vol. 77, no. 3 (Fall 2018): 611-637.

⁶ Mbi procesin e destalinizimit në Shqipëri, shih Ana Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e 1956-s* (Tirana: Infbotues, 2015); Elidor Mëhilli, “Defying De-Stalinization: Albania’s 1956”, *Journal of Cold War Studies*, vol. 13, no. 4 (2011): 4-56.

Bllokut Lindor, rieksporthe nga Lindja dhe Perëndimi, dhe përdorimin e infrastrukturës ndërkombëtare portuale dhe financiare për shkëmbim ekonomik. Megjithatë, rritja e shkëmbimeve ekonomike ekspozoi gjithashtu të gjitha limitet e infrastrukturës ekonomike të Shqipërisë dhe kapacitetin e saj të kufizuar për të përballuar flukset tregtare ndërkombëtare përtej atyre që rezultonin nga aleanca me Kinën.

Peizazhi i ndihmës dhe i shkëmbimeve ekonomike të Shqipërisë së viteve 1950

Ndihma sovjetike dhe KNER-i në një masë të madhe formësoi ekonominë e Shqipërisë gjatë viteve 1950. Qeveria komuniste e Tiranës kishte dy arsye kryesore për të kërkuar mbështetjen e Moskës për investime në industri, zhvillimi i të cilave mund të shërbente për dy qëllime: *së pari*, duke ndjekur një formë industrializimi të bazuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore, si nafta dhe mineralet (sado të kufizuara) në zotërim të vendit, ekonomia shqiptare do të bëhej më konkurruese brenda Kampit Komunist dhe do të mund të përballonte ritmin e rritjes së shkëmbimeve tregtare brenda Bllokut. Çështja do të bëhej urgjente duke pasur parasysh bilancin negativ tregtar të Shqipërisë me bllokun sovjetik, bilanc të cilin shqiptarët e vlerësonin se do të vazhdonte të paktën deri në vitin 1975.⁷ Një ekonomi konkurruese brenda Kampit Socialist, kishte potencialin të përkthehej në një autonomi më të madhe vendimmarrëse të autoriteteve shqiptare; *së dyti*, ndërtimi i një industrie të zhvilluar vendëse, do t'i shërbente edhe qëllimit të deklaruar të Shqipërisë për të krijuar një klasë punëtore urbane nga një shoqëri kryesisht rurale. Në këtë mënyrë do të zgjerohej baza politike e Partisë Komuniste, dhe po kështu do të zgjerohej edhe legjitimiteti i saj ideologjik. Siç ka argumentuar Besnik Pula, për liderët shqiptarë zhvillimi i industrisë nuk ishte thjesht një politikë e qeverisë, por “vetë mjeti me të cilin [regjimi] do të legjitimonte sundimin [e tij]”.⁸ Në këtë

⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 495, Viti (më tej: V.) 1959, Dosja (më tej: D.) 2, fl. 10. Relacion i kryetarit të Komisionit të Planit të Shtetit mbi problemet e diskutuara me shokët sovjetikë, Tiranë, 15 maj 1959.

⁸ Pula, *Globalization Under & After Socialism*, 38.

kuptim, që nga fillimi i qeverisjes së Partisë Komuniste në Shqipëri, zhvillimi i industrisë ishte një objektiv madhor ekonomik.

Udhëheqësit shqiptarë e parashikuan një mundësi të tillë që nga viti 1948, që shënoi fillimin e ndihmës së drejtpërdrejtë sovjetike për Shqipërinë pas ndërprerjes së marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë kur Beogradi u përjashtua atë verë nga Kominform-i (Zyra e informacionit e partive komuniste).⁹ Shpejt pasoi transferimi i parë i kredisë nga Bashkimi Sovjetik në rreth 20 milionë dollarë amerikanë.¹⁰ Për më tepër, në Tiranë, ndihma e drejtpërdrejtë sovjetike shihej si një mundësi për të reduktuar hendekun ekonomik midis Shqipërisë dhe pjesës tjetër të Europës Lindore dhe për të marrë investime për industrializimin e vendit. Mirëpo Stalini, ndoshta duke kujtuar gabimet e tij dhe kostot njerëzore të industrializimit të sforcuar në Bashkimin Sovjetik gjatë viteve 1930, por ndoshta duke konsideruar edhe avantazhet ekonomike për Bllokun, këshilloi liderin shqiptar Enver Hoxha në vitin 1949 që të ndiqte zhvillimin ekonomik nëpërmjet transformimeve graduale, të cilat do të lejonin një shkallë fillestare të akumulimit të kapitalit.¹¹ Stalini sugjeroi që fshatarësia të kishte njëfarë lirie për të tregtuar tepricat e prodhimit të tyre.

Duke pohuar se “Shqipëria është një vend i prapambetur”, Stalini ngriti me kuriozitet rastin e Kinës si një shembull që Shqipëria duhej të ndiqte, në atë që – argumentoi ai – udhëheqësit komunistë kinezë kishin bërë aleancë me borgjezinë dhe klasën kapitaliste të Kinës kundër pushtimit japonez dhe më pas kishin lejuar që aktivitetet e tyre ekonomike të lulëzonin. Ai sugjeroi që Shqipëria të ndiqte të njëjtën

⁹ Jeronim Perović, “The Tito-Stalin Split: A Reassessment in Light of New Evidence”, *Journal of Cold War Studies*, vol. 9, no. 2 (2007): 42-57; Ylber Marku, “Shifting Alliances: Albania in the Early Cold War”, *Journal of Cold War Studies*, vol. 24, no. 3 (2022): 80-115.

¹⁰ AQSH, F. 14/Arkivi i Partisë (AP) - Organet Udhëheqëse (OU), V. 1949, D. 1, fl. 24. Procesverbal i Plenumit të Dytë të Kongresit I të PPSH-së, 28 prill 1949.

¹¹ Ronald Grigor Suny, *The Soviet Experiment. Russia, the USSR, and the Successor States*, New York and Oxford: Oxford University Press, 2011, 188-212; Lewis H. Siegelbaum, *Soviet state and society between revolutions, 1918-1929*, New York, and Cambridge: Cambridge University Press, 1992; Shih gjithashtu Sheila Fitzpatrick, Alexander Rabinowitch and Richard Stites (eds.), *Russia in the Era of NEP: Explorations in Soviet Society and Culture* (Bloomington and Indianapolis: Indiana University Press, 1991).

rrugë, përveçse, sigurisht, “nëse i keni vrarë të gjithë [borgjezinë]”.¹² Në fakt, kjo është pikërisht ajo që kishin bërë udhëheqësit shqiptarë, pasi kishin shfuqizuar pothuajse të gjithë sektorin privat në vitet 1945-46 dhe kishin shpronësuar, vrarë ose burgosur, shumicën e anëtarëve të së ashtuquajturës klasë borgjeze që zotëronte industri të vogla.¹³

Perspektiva për të pasur një pjesë nga torta e progresit socialist sovjetik dukej premtuese kur Moska dha një hua prej 65 milionë rublash për planin e parë pesëvjeçar të Shqipërisë, 1951-1955 – shumë e cila shkoi për projekte në bujqësi dhe disa investime industriale, kryesisht në projekte të tilla si, ndër të tjera, në nxjerrjen e naftës, industrinë tekstile, së bashku me një oficinë në portin e Durrësit për riparimin e anijeve.¹⁴ Në të njëjtën kohë, Moska i konsideroi shumë nga objektivat e planit pesëvjeçar në Shqipëri tepër ambicioze – Shqipëria në atë kohë kishte një popullsi prej më pak se 1.5 milionë banorë dhe i mungonte fuqia punëtore e specializuar. Rrjedhimisht, qeveria sovjetike refuzoi të ofronte investime në shkallë të gjerë në infrastruktura të tilla si hekurudhat dhe industrinë e lidhura me metalurgjinë, dhe ridimensionoi ndihmat për kërkime të reja të rezervave të naftës.¹⁵

¹² ‘Record of I. V. Stalin's Conversation with E. Hoxha concerning Albanian-Yugoslavian Relations and the Foreign and Domestic Policy of Albania,’ March 23, 1949, History and Public Policy Program Digital Archive, *Vostochnaia Evropa*, edited by G.P. Murashko et al, vol. 2, pp. 44-57 (APRF, f. 45, op. 1, d. 249, l. 5 5-74) <http://digitalarchive.wilsoncenter.org/document/134384> (shikuar më 20.12.2023).

¹³ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. V, Beqir Meta (red. përgj.), grup autorësh (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2023), 52, 67-71, 408-423; Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse e Shqipërisë nën Komunizëm (1945-1967)* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2022), 100-107; Gjon Boriçi, *Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri (nëntor 1944 - dhjetor 1949)*, (në proces aprovim botimi).

¹⁴ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1951, D. 28, fl. 11-49. Protokoll i mbledhjes së Byrosë Politike, 21 maj 1951; *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë së Jashtme, V. 1951, D. 62, 09.02.1951. “Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Bashkimit Sovjetik mbi dhënien Shqipërisë materiale industriale me kredi dhe protokollin përkatës i kësaj marrëveshjeje”.

¹⁵ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë së Jashtme, V. 1953, D. 21, fl. 38-41. Relacion i këshilltarit tregtar në Moskë, Niayi Domi, mbi punën e delegacionit tregtar gjatë bisedimeve për mbylljen e marrëveshjeve të vitit 1953, drejtuar Ministrisë së Tregtisë në Tiranë, 16 prill 1953; shih gjithashtu *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë së Jashtme, V. 1953, D. 22, D. 23, D. 24.

Ashtu si me Bashkimin Sovjetik, në vitin 1951 Shqipëria arriti disa marrëveshje për ndihmë ekonomike edhe me vendet e tjera socialiste të Europës Lindore, më e madhja prej të cilave ishte me Çekosllovakinë prej 55 milionë rublash, e ndjekur nga ajo me Gjermaninë Lindore me 50 milionë rubla. Kushtet, megjithatë, nga Tirana u konsideruan si “jo të favorshme” sepse ato u nënshtroheshin një sërë kriterëve, si shlyerjet duke filluar nga viti i parë i huas, dhe studimet e projektet për fabrikat e plota duhej të jepeshin nga Shqipëria brenda disa afateve strikte, së bashku me listat specifike të artikujve të nevojshëm për ndërtim.¹⁶ Nga ana tjetër, qindra specialistë nga Bashkimi Sovjetik dhe vende të Europës Lindore, si Çekosllovakia, Gjermania Lindore dhe Hungaria, shkuan në Shqipëri gjatë kësaj periudhe, duke këshilluar, planifikuar, projektuar dhe ndërtuar.¹⁷

Pas vdekjes së Stalinit, ndihma e Moskës u rrit dhe qeveria sovjetike ofroi ndihmë në formën e pajisjeve dhe materialeve që ata më parë shpesh i kishin refuzuar.¹⁸ Nën drejtimin e Nikita Hrushovit, “udhëheqja sovjetike filloi të kishte një pikëpamje të re mbi rëndësinë e tregtisë dhe rolin e saj në zhvillimin e brendshëm dhe brenda bllokut komunist”.¹⁹ Por, problemet e Shqipërisë duket se nuk kanë qenë një prioritet në agjendën e Hrushovit dhe ai rrallë u mor personalisht me ndihmën sovjetike për Shqipërinë. Qeveria e tij u bë edhe më këmbëngulëse sesa kishte qenë Stalini në adresimin e ndihmës sovjetike drejt industrisë së lehtë dhe bujqësisë së Shqipërisë, për të cilën Moska ishte e gatshme të jepte “edhe më shumë se sa ju [Shqipëria] keni kërkuar”.²⁰ Kjo politikë shkonte në linjë me rëndësinë më të madhe që i

¹⁶ *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1951, D. 28, fl. 19. Protokoll i mbledhjes së Byrosë Politike më 21 maj 1951. “Mbi rezultatet e marrëveshjeve me B.S., dhe demokracitë e tjera popullore për kërkesat tona për planin pesëvjeçar 1951-1955”.

¹⁷ *Po aty*, F. 490, V. 1956, D. 1076, fl. 134-174. Ministria e Industrisë dhe e Minierave, drejtuar Kryeministrit, 31 tetor 1956. “Bashkangjitur ju dërgojmë pasqyrat mbi nevojat për specialistë që ka ky dikaster për të ardhur nga B. S., dhe demokracitë e tjera popullore për vitet 1957-1960”.

¹⁸ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1956, D. 271. “Marrëveshje mbi dhënie të një kredie afatgjatë Republikës Popullore të Shqipërisë nga ana e Bashkimit Sovjetik si dhe letra që Kryeministri i Republikës Popullore të Shqipërisë i dërgon Kryeministrit të Bashkimit Sovjetik”, maj 1956.

¹⁹ Pula, *Globalization Under & After Socialism*, 36.

²⁰ *AQSH*, F. 490, V. 1954, D. 223, fl. 3. “Proçesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, datë 2.7.1954 mbi shqyrtimin e rezultateve të punës së delegacionit tonë

jepej sektorit të industrisë së lehtë në kuadër të procesit të përgjithshëm të destalinizimit, e cila tani dukej se ishte fokusuar në prodhimin e më shumë mallrave të konsumit.

Në parim, sovjetikët ishin në favor të ndërtimit të industrisë, por një industri e tillë në Shqipëri kërkonte investime të konsiderueshme në infrastrukturë, kërkime, pajisje dhe burime njerëzore për një periudhë relativisht të gjatë përpara se të kishte një rikthim ekonomik. Pra, nga këndvështrimi i Moskës, mënyra më e mundshme që Shqipëria të ishte konkurruese në tregun socialist europian dhe më gjerë, ishte të shfrytëzonte pozicionin e Shqipërisë si një vend mesdhetar dhe të fokusohej në prodhimin e produkteve bujqësore për të cilat klima ishte e favorshme dhe që ishin të vështira për t'u prodhuar në Bashkimin Sovjetik. Prandaj, Moska ishte në favor të zhvillimit së pari të industrisë së lehtë të Shqipërisë, veçanërisht asaj që lidhej me pajisjet e nevojshme për prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë si birra, mishi, fabrikat e konservimit dhe të përpunimit të ushqimit, veglat dhe pjesët e këmbimit për pajisjet e makineritë industriale të importuara.²¹ Ky qëndrim u pasqyrua edhe në ndihmën sovjetike të dhënë për planin e dytë pesëvjeçar të Shqipërisë, 1956-1960. Në këtë plan, Moska u angazhua për ndihmë të konsiderueshme me disa projekte në industrinë e lehtë, si, ndër të tjera, fabrikat e sheqerit, fabrikat e çimentos, pajisjet ftohëse për produktet bujqësore, projektet që lidhen me prodhimin e alkoolit dhe mbështetjen e industrisë së vogël të peshkimit duke zgjeruar flotën me 20 varka të reja peshkimi. Për sa i përket industrisë, Moska pranoi vetëm të ndihmonte me studimin e nxjerrjes së naftës dhe ekspeditave gjeologjike për lëndët e para të nevojshme për industrinë, por në këtë fazë kufizoi investimet e drejtpërdrejta në zhvillimin e tyre.²² Ndihma ekonomike nga Moska rezultoi gjithashtu në rritjen e përfshirjes së ekspertëve sovjetikë, të cilët morën një rol udhëheqës në zbatimin e shumë projekteve ekonomike që

qeveritar që ishte në Moskë për disa çështje qeveritare”, Mbledhja e qeverisë në Tiranë”, 2 korrik 1954.

²¹ *Po aty*, fl. 2-6.

²² *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1957, D. 227, fl. 1-45.; *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1959, D. 195, fl. 2-9. Relacion i ministrit të Tregtisë Kiço Ngjela, drejtuar Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH-së për shokun Enver. “Mbi përfundimin e marrëveshjeve për sigurimin e planit të eksport-importit për vitin 1959 si dhe mbi sigurimin e objekteve”, 2 qershor 1959.

kufizuan autonominë e Shqipërisë në ndjekjen e planeve të saj ekonomike.²³

Në fakt, sovjetikët, me kapacitetet e tyre të avancuara të planifikimit, ekspertizën dhe arritjet e tyre teknologjike, ekspozuan të gjithë kufijtë e ekonomisë shqiptare. Planifikuesit dhe punëtorët vendës e patën të vështirë të përshtateshin me këtë kulturë të re materiale. Shpesh, ata do ta gjenin veten pa shumë zë në zbatimin e projekteve të financuara nga sovjetikët dhe do të vareshin nga komandat dhe direktivat e ekspertëve sovjetikë.²⁴ Problemet e shumta lidhur me planifikimin, trajnimin, autoritetin, pagat dhe të ndonjë natyre tjetër u bënë një model i zakonshëm edhe në bashkëpunimin ekonomik dhe shkëmbimet e Shqipërisë me vendet e Europës Lindore.²⁵ Në fakt, raportet e detajuara për strehimin dhe trajtimin ekonomik të specialistëve nxjerrin në pah diferencën e madhe mes pagave të specialistëve shqiptarë dhe atyre sovjetikë e europianolindorë, ku këta të fundit, në krahasim me punëtorët e specialistët vendës, kërkonin dhe kishin kushte shumë më të mira jetese me një sforcim të konsiderueshëm të buxhetit të shtetit.²⁶

Këto dallime në kulturën ekonomike dhe hierarkitë e vendosura midis sovjetikëve (dhe europianolindorëve) dhe Shqipërisë sollën mosmarrëveshje në planifikimin e projekteve ekonomike midis palëve. Rrjedhimisht, Moska u bë më përlllogaritëse dhe më e vetëdijshme për kapacitetet e kufizuara të Shqipërisë në zbatimin e projekteve ekonomike. Hezitimi i Moskës për të përmbushur kërkesat ekonomike të Shqipërisë në lidhje me industrinë e rëndë luajti një rol të drejtpërdrejtë në afrimin e Tiranës me Pekinin. Megjithatë, përvoja me sovjetikët u kthye e dobishme për Komisionin e Planit të Shtetit në Shqipëri, i cili në prill të vitit 1958 hartoi një listë gabimesh të bëra me projektet e mbështetura nga sovjetikët, si, ndër të tjera, mungesa e studimeve serioze në lidhje me burimin e furnizimit me energji, vendndodhjen e projekteve, fuqinë

²³ *Po aty*, F. 503/Ministria e Tregtisë së Jashtme, V. 1953, D. 21, fl. 38-41. “Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Bashkimit Sovjetik mbi dërgimet reciproke të mallrave për vitin 1953 si dhe listat përkatëse të import-eksportit”, 8 prill 1953.

²⁴ Mëshilli, *From Stalin to Mao*.

²⁵ Mëshilli, “Socialist Encounters”, 117-128.

²⁶ *AQSH*, F. 503/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 241, fl. 61-62. Kryeministria drejtuar gjithë ministrive dhe institucioneve qendrore. “Mbi disa çështje të trajtimit të specialistëve të huaj”, 5 nëntor 1960.

punëtore, ndikimin në mjedis dhe trajtimin e mbetjeve të prodhuara nga këto fabrika. Synimi ishte të kufizohet një neglizhencë e tillë me kinezët, megjithëse ato do të dilnin në sipërfaqe në vitet në vijim.²⁷

Një faktor tjetër i rëndësishëm në marrëdhëniet ekonomike sovjeta-shqiptare që krijoi pakënaqësi në Tiranë, kishte të bënte me vendin e Shqipërisë në ndarjen e punës në kuadrin e KNER-it. Në vitin 1957, një studim ekonomik për zhvillimin industrial dhe bujqësor të Shqipërisë deri në vitin 1975, i hartuar nga ekspertë sovjetikë pas vizitës në Shqipëri, u përqendrua shumë në zhvillimin bujqësor dhe industrial të vendit, me synimin për të arritur një shkallë të caktuar të vetëmjaftueshmërisë ekonomike, megjithëse ata nuk ishin në favor të autarkisë ekonomike.²⁸ Dokumenti pasqyrore një lloj ndarjeje të punës brenda KNER-it, e cila shkonte në përputhje me atë që dëshironin zyrtarët sovjetikë.²⁹ Siç ka argumentuar Mëhilli, “përpjekjet për të integruar ekonominë socialiste u intensifikuan në fund të viteve 1950”, e cila u tentua gjithashtu përmes një përpjekjeje (të dështuar) për të “ringjallur KNER-in dhe për të krijuar një ndarje të re ndërkombëtare socialiste të punës”.³⁰ Shqipëria do të penalizohet edhe më shumë nga propozimi i Bashkimit Sovjetik në vitin 1957 për të vendosur për anëtarët e KNER-it çmime tregtare në përputhje me çmimet në tregjet ndërkombëtare, gjë që për Shqipërinë, e mbështetur shumë në importe, nënkuptonte importime të shtrenjta të produkteve industriale dhe pak

²⁷ *Po aty*, F. 495, V. 1958, D. 762, fl. 7-8. Relacion i kryetarit të Komisionit të Planit të Shtetit, Spiro Koleka, dërguar Ministrisë së Industrisë dhe Ministrisë së Komunikacionit, Tiranë, 1 prill 1958; *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 262. Korrespondencë nga data 13.11.1959 deri më 12.12.1960, e Ministrisë së Tregtisë me Këshillin e Ministrave dhe atasheun tregtar në Moskë, në lidhje me ndërtimin e projekteve të reja me ndihmën e Bashkimit Sovjetik.

²⁸ *Po aty*, F. 14/KNER [Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke], V. 1958, D. 2, fl. 7-12. Informacion mbi punën e bërë për projektplanin mbi perspektivat e zhvillimit ekonomik, 22 mars 1958.

²⁹ *Po aty*, F. 14/KNER, V. 1958, D. 3, f. 1-12. Informacion i zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Spiro Koleka, mbi punën e sesionit të 9-të të KNER-it, zhvilluar në Bukuresht nga data 26 deri më 30 qershor 1958; *po aty*, F. 14/KNER, V. 1961, D. 10, fl. 11. Projektplan i përkthyer në shqip (nga rusishtja) mbi parimet kryesore të ndarjes ndërkombëtare të punës socialiste përgatitur nga ekspertë të vendeve anëtare të KNER-it, 1 gusht 1961.

³⁰ Mëhilli, “Socialist Encounters”, 112.

përfitim nga eksportet e saj të kufizuara.³¹ Qëllimi ishte krijimi i një lloj specializimi ekonomik midis vendeve të Europës Lindore që do t'i ndihmonte ato të integroheshin në rrjetin e tregtisë ndërkombëtare. Siç argumentohet në një studim së fundmi, “koordinimi i tregtisë së jashtme të anëtarëve të tij me Perëndimin ishte misioni i parë i KNER”.³²

Vendimi për çmimet brenda Bllokut u rishikua në seancën e nëntë të KNER-it në qershor të vitit 1958, ku ato u vendosën në bazë të çmimeve mesatare të tregtisë së pesë viteve të fundit, me përjashtim të artikujve të veçantë (të paspecifikuar), të cilët u lanë në vendimet dypalëshe.³³ Por për Shqipërinë, vetëm vënia në rendin e ditës dhe diskutimi i mundësisë së lidhjes së çmimeve të tregtisë mes vendeve socialiste me ato të tregtisë me tregjet ndërkombëtare ngriti çështje të solidaritetit internacionalist (më saktë mungesën e tij) midis anëtarëve të KNER-it. Këta [anëtarët e KNER-it] sipas fjalëve të delegatit shqiptar, “përdorin gjuhën e tregtarit” në vend të asaj të vëllazërisë socialiste.³⁴ Në këtë integrim ekonomik socialist të parashikuar rishtazi dhe ndarje të punës në Europën Lindore, liderët shqiptarë ishin të pakënaqur me vendin e Shqipërisë. Ata ndiheshin të margjinalizuar dhe me pak autonomi në lidhje me modelin e zhvillimit ekonomik afatgjatë të vendit. Rrjedhimisht, me daljen në pah të Pekinit si një partner angazhues me

³¹ *AQSH*, F. 14/KNER, V. 1958, D. 2, fl. 4-6. Informacione pa firmë. “Informacion mbi problemin e çmimeve midis vendeve pjesëmarrëse në Këshillin Ekonomik”, 22 mars 1958.

³² Laurien Crump and Simon Godard, “Reassessing Communist International Organisations: A Comparative Analysis of COMECON and the Warsaw Pact in relation to their Cold War Competitors”, *Contemporary European History*, vol. 27 no. 1 (2018): 85-109.

³³ *AQSH*, F. 14/KNER, V. 1958, D. 3. “Kopje e informacionit të zv/kryeministrit, Spiro Koleka, mbi punimet e sesionit të IX të Këshillit Ekonomik të Ndhmës Reciproke, mbajtur në Bukuresht nga data 26.6.1958 deri më 30.6.1958”; shih gjithashtu Iskra Baeva, “Bulgarisch-sowjetische Wirtschaftsbeziehungen nach dem Zweiten Weltkrieg”, in Walter M. Iber, and Peter Ruggenthaler (Ed.), M. Iber Walter und Ruggenthaler Peter (Hg.), *Stalins Wirtschaftspolitik an der sowjetischen Peripherie. Ein Überblick auf der Basis sowjetischer und osteuropäischer Quellen* (Innsbruck, Wien, Bozen: Studienverlag, 2011), 161-182, 171.

³⁴ *AQSH*, F. 14/KNER, V. 1961, D. 8, fl. 2-12. Relacion i delegatëve shqiptarë në KNER, Shefqet Kruja dhe Vasil Duro. “Në lidhje me punimet e grupit të punës për trajtimin e specialistëve dhe të teknikëve në kuadrin e Këshillit Ekonomik dhe të Ndhmës Reciproke”, Tiranë, 15 qershor 1961.

vendet e Europës Lindore, Shqipëria nisi një proces afrimi politik dhe ekonomik me Kinën.

Vëzhgimi i ekonomisë së Kinës nga Shqipëria

Që nga viti 1954, politikat e reja ekonomike dhe të bllokut sovjetik të prezantuara nga Bashkimi Sovjetik pas Stalinit i dhanë shumë më tepër hapësirë Kinës për t'u angazhuar me bllokun e vendeve socialiste në Europë.³⁵ Rrjedhimisht, deri në mosmarrëveshjet e shfaqura kino-sovjetike në fund të viteve 1950, shkëmbimet në të gjitha nivelet midis Kinës dhe vendeve socialiste europiane u rritën.³⁶ Në këtë kuadër dhe për këtë arsye, u rritën edhe shkëmbimet e Kinës me Shqipërinë. Edhe pse marrëdhëniet diplomatike mes Kinës dhe Shqipërisë u vendosën në nëntor të vitit 1949, deri në vitin 1954 ato u kufizuan kryesisht në letra urimi për festat kombëtare.

Bashkëpunimi ekonomik midis Kinës dhe Shqipërisë nga viti 1954 është veçanërisht i rëndësishëm sepse në vitin 1953 Kina shpalli një politikë të re ekonomike të quajtur “vija e përgjithshme për tranzicionin socialist”, e cila u fokusua në kolektivizimin e bujqësisë dhe industrializimin e ekonomisë, të cilën Hua-Yu Li e konsideronte “një formë e stalinizmit në Kinë kundër këshillës së vetë Stalinit”.³⁷ Ky ndryshim i politikës së modelit ekonomik kinez shkoi në drejtim të kundërt nga ai më pragmatik që filluan të promovonin pasardhësit e Stalinit në ato vite e në vazhdim. Në shtator të vitit 1954, krerët kinezë inkurajuan ministrin e Jashtëm shqiptar, Behar Shtylla, i cili vizitoi Kinën për herë të parë atë vit, për të bërë kërkesa specifike për ndihmë të drejtpërdrejtë ekonomike dhe theksuan rëndësinë e zhvillimit të

³⁵ Hua-Yu Li, *Mao and the Economic Stalinization of China, 1948-1953* (Oxford, UK, and New York: Rowman & Littlefield Publishers, 2006), 3; Margaret K. Gnoinska, “Chipolbrok – Continuity in Times of Change: Sino-Polish Relations during the Cold War, 1949-1969”, in Janick Marina Schaufelbuehl, Marco Wyss, Valeria Zanier (eds.), *Europe and China in the Cold War. Exchanges beyond the Bloc Logic and the Sino-Soviet Split* (Leiden and Boston: Brill, 2019), 192-2011.

³⁵ Zhihua Shen and Yafeng Xia, *Mao and the Sino-Soviet Partnership, 1945-1959. A New History* (Lanham, Maryland: Lexington Books, 2015), 101-131.

³⁶ Austin Jersild, “Socialist exhibits and Sino-Soviet relations, 1950-60”, *Cold War History*, vol. 18, no. 3 (2018): 275-289.

³⁷ Li, *Mao and the Economic Stalinization of China*, 3.

industrisë.³⁸ Shumë shpejt, Kina dha një kredi prej 30 milionë rubla.³⁹ Duke dërguar shenja të mëtejshme gatishmërie për marrëdhënie më të ngushta me Shqipërinë, në vitin 1955 Kina pranoi të ofronte një sërë produktesh, pjesërisht duke i blerë ato në vende të tjera, duke përfshirë, 40 tonë gomë, 30 tonë rrjeta peshkimi, 50 tonë kafe, 500 tonë qumësht pluhur, mijëra tonë pambuk dhe qindra tonë lubrifikantë industrialë.⁴⁰ Edhe pse kjo ishte vetëm një kredi, ajo hapi terrenin për negociatat e marrëveshjeve afatgjata midis Kinës dhe Shqipërisë.

Në shtator të vitit 1956, Hoxha vizitoi personalisht Kinën i ftuar për të marrë pjesë në Kongresin e Tetë të Partisë Komuniste Kineze (PKK).⁴¹ Ka paqartësi dhe kontradikta në përshtypjet fillestare të udhëheqësve shqiptarë mbi Kinën. Ndonëse Hoxha ishte i impresionuar gjatë vizitës së tij, ai e kishte “të vështirë të kishte një ide të qartë” për Kinën. Në Pekin, liderët shqiptarë gjetën entuziazëm të jashtëzakonshëm në lidhje me të ardhmen ekonomike të Kinës. Udhëheqësit kinezë u thanë atyre se Kina planifikonte të arrinte industrializimin e plotë në vetëm dhjetë vjet.⁴² Në këtë periudhë kohore, rëndësia që i kushtonte Kina industrisë së rëndë pasqyronte me siguri atë që Amy King e ka quajtur “ndjenjë e urgjencës” midis sundimtarëve kinezë për ta transformuar Kinën në një ekonomi të

³⁸ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1954, D. 39, f. 11-14. Relacion i shokut Behar Shtylla mbi vizitën e tij në Republikën Popullore të Kinës, Tiranë, 3 nëntor 1954.

³⁹ Për një listë të plotë të kredive dhe ndihmave të Kinës për Shqipërinë gjatë viteve 1954-1960, shih studimin e fundit nga Gjon Boriçi, *Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze, 1954-1960* (Tiranë: Geer, 2023); Shih gjithashtu Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë, 1956-1978* (Tiranë: Geer, 2022).

⁴⁰ *AQSH*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1955, D. 328, fl. 2. Dokument me listat e mallrave të importuara nga Kina në vitin 1955, 5 tetor 1955

⁴¹ *Po aty*, F. 14/AP-Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Kinës (MPKK), V. 1956, D. 2. Korrespondencë mes Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, mbi pjesëmarrjen e delegacionit shqiptar të udhëhequr nga shoku Enver Hoxha në punimet e Kongresit të Tetë të Partisë Komuniste të Kinës.

⁴² *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1956, D. 54, fl. 10. Relacion i delegacionit shqiptar që mori pjesë në punimet e Kongresit të Tetë të Partisë Komuniste Kineze në Pekin, Tiranë, 9 tetor 1956; *Technology Transfer to China*, OTA-ISC-340, U.S. Congress, Office of Technology Assessment (Washington, DC: U.S. Government Printing Office, July 1987), 40.

fuqishme industriale.⁴³ Në kontrast me këtë pamje optimiste, Hoxha pohoi se si ata “nuk panë asnjë traktor” në fermat që vizituan dhe se pjesa më e madhe e punës në bujqësi kryhej me dorë dhe forcën e krahut.⁴⁴ Hoxha vuri në dukje se si Anshani, të cilin ai e vizitoi sepse ishte qendra më e madhe metalurgjike e Kinës, nuk kishte “kamionë apo automjete në lëvizje, pavarësisht se kishte rreth 70 mijë punëtorë”.⁴⁵ Kështu, shqiptarët e kishin të vështirë të shpërfillnin atë që vetë zyrtarët kinezë pranuan, që ishte “mungesa ekstreme e teknologjisë dhe aftësive industriale të Kinës”, dhe fakti që ekonomia e Kinës ishte ende “shumë e prapambetur industrialisht”.⁴⁶ I vetëdijshëm për dallimet kulturore, gjeografike dhe historike mes dy vendeve, Hoxha theksoi se “nuk mund të ketë paralelizëm mes nesh dhe Kinës, pasi kushtet mes dy vendeve janë krejtësisht të ndryshme”.⁴⁷

Nga ana tjetër, si Pekini ashtu edhe Tirana kishin të përbashkët prapambetjen ekonomike. Shqipëria përfaqësonte vendin më të pazhvilluar brenda Kampit Socialist të Europës Lindore dhe Kina, e dalë nga Lufta e Dytë Botërore së pari, nga lufta civile dhe më vonë edhe nga përfshirja e Pekinit në Luftën e Koresë, mbeti shumë prapa Bashkimit Sovjetik dhe ishte një vend kryesisht agrar. Tirana dhe Pekini kishin gjithashtu ngjashmëri të pabesueshme në lidhje me hendekun e madh në zhvillim midis popullsisë urbane dhe rurale, ku kjo e fundit përbënte shumicën dërrmuese në të dyja vendet. Por, ndërsa në Shqipëri Partia Komuniste u krijua si një organizatë politike e bazuar kryesisht në zonat urbane, në Kinë, “që nga themelimi, fshatarësia kishte një pozicion

⁴³ Amy King, “Reconstructing China: Japanese technicians and industrialization in the early years of the People’s Republic of China”, in *Modern Asian Studies*, vol. 50, no. 1 (2016): 141-174, 143.

⁴⁴ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1956, D. 54, fl. 11. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, më 9 tetor 1956. Në këtë mbledhje raportoi Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu mbi pjesëmarrjen e tyre në Kongresin e Tetë të Partisë Komuniste Kineze, si dhe vizitat në Kinë e takimet e bëra me udhëheqësit kinezë.

⁴⁵ *Po aty*, f. 15.

⁴⁶ King, “Reconstructing China”, 143, 153.

⁴⁷ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1956, D. 54, f. 10. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, më 9 tetor 1956. Në këtë mbledhje raportoi Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu mbi pjesëmarrjen e tyre në Kongresin e Tetë të Partisë Komuniste Kineze, si dhe vizitat në Kinë e takimet e bëra me udhëheqësit kinezë.

qendror në farkëtimin e identitetit të revolucionit komunist kinez”.⁴⁸ Kështu, revolucioni komunist i Kinës me bazë rurale mundësoi mobilizimin e vazhdueshëm të fshatarëve pas vitit 1949. Edhe më i rëndësishëm ishte fakti se, si Kina ashtu edhe Shqipëria u përpoqën të ndiqnin një interpretim ortodoks të marksizmit që u përshtatej më së miri synimeve politike të udhëheqësve të tyre përkatës. Në një kohë kur Hrushovi po largonte Bashkimin Sovjetik nga trashëgimia e Stalinit, Kina dhe Shqipëria, me dallimet përkatëse, ishin sigurisht në favor të stalinizmit – politikisht duke centralizuar pushtetin në pak duar, duke forcuar kultin e personalitetit dhe ekonomikisht duke i dhënë përparësi industrializimit të rëndë. Për më tepër, procesi i destalinizimit i nxitur nga Hrushovi e afroi Tiranën me Pekinin. Kjo pozitë u përforcua edhe më shumë pasi shpërthyen protesta masive kundër sundimit komunist në Poloni dhe në Hungari. Situata u përshkallëzua deri në atë pikë sa Moska duhej të dërgonte ushtrinë në Budapest për të rivendosur rendin. Këto ngjarje afruan Kinën dhe Shqipërinë së bashku për të formuar gradualisht një front opozitar ndaj reformizmit të Hrushovit.⁴⁹

Rritja e marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Kinës

Nga fundi i viteve 1950, me shumë projekte ekonomike dhe plane industriale të refuzuara nga Moska, së bashku me mosmarrëveshjet politike me udhëheqësit sovjetikë, liderët shqiptarë filluan ta shohin Pekinin si një alternativë të mundshme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Shqiptarët e panë me interes modelin kinez të mobilizimit rural, i cili e vinte theksin tek industrializimi, por edhe qasjen e Kinës ndaj ndihmës së dhënë për vendet e huaja. Të paktën në rastin e Shqipërisë, Kina, ndryshe nga Moska, fillimisht shmangu çdo ndërhyrje në lidhje me mënyrën se si Shqipëria do të zbatonte projektet e financuara nga Kina. Huaja e Kinës prej 80 milionë rublash për planin e dytë pesëvjeçar të Shqipërisë, 1955-1960, dhe një hua tjetër prej 55 milionë rublash në tetor të vitit 1958 për planin e tretë pesëvjeçar të Shqipërisë,

⁴⁸ Ylber Marku, *Sino-Albanian relations during the Cold War, 1949-1978: An Albanian perspective*, Doctor's thesis, Lingnan University, Hong Kong: 2017. Retrieved from http://commons.ln.edu.hk/his_etd/11/, 167. (shikuar më 18.10. 2023).

⁴⁹ Elidor Mëhilli, “Defying De-Stalinization: Albania's 1956”, *Journal of Cold War Studies*, vol. 13, no. 4 (2011): 4-56; Shen and Xia, *Mao and the Sino-Soviet Partnership*, 145-152.

1961-1965 synonin të kontribuonin në objektivin e planit për “transformimin e Shqipërisë nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar”.⁵⁰ Siç tregohet në aneksin e letrës, kjo ndihmë do të adresohet kryesisht për ndërtimin e fabrikave. Synimi ishte të kompensoheshin refuzimet e shumta, ose të paktën modifikimet, e projekteve industriale nga sovjetikët. Për më tepër, në dobi të Tiranës, Kina po ofronte mbështetje me teknologjinë e zhvilluar shpesh në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Europës Lindore, por pa kufizimet e planifikimit që kishin vendosur sovjetikët.

Gjithashtu, drejtuesit shqiptarë fillimisht menduan se mund të merrnin teknologji industriale të zhvilluara nga vetë Kina. Për këtë qëllim në vitin 1954 u nënshkrua një marrëveshje në lidhje me bashkëpunimin tekniko-shkencor, në të cilën të dyja vendet u angazhuan për të shkëmbyer informacion dhe ekspertizë dhe për të transferuar njohuri në fushën e teknologjive të reja të zhvilluara, të aksesuara ose të zotëruara nga secili vend.⁵¹ Në fakt, në vend të teknologjive, u shkëmbyen më shumë produkte të gatshme. Por për Shqipërinë marrëdhëniet politike, shkëmbimet ekonomike dhe ndihma e drejtpërdrejtë ishin të gjitha baza për të testuar gatishmërinë dhe kapacitetin kinez për të ndihmuar Shqipërinë.

Në kuadër të bashkëpunimit tekniko-shkencor, kërkesat e para të Shqipërisë për Kinën shkonin nga projektimet e një fabrike për përpunimin e mëndafshit (nga fijet te produkti përfundimtar) tek udhëzimet për rritjen e bimëve mjekësore. Sigurisht, industria e tekstitit në Shqipëri fillimisht u ndërtua me ndihmën e konsiderueshme sovjetike, por sovjetikët refuzuan ta mbështetnin zgjerimin e kësaj industrie në masën që kërkuan shqiptarët.⁵² Por më thelbësisht, Shqipëria shfrytëzoi

⁵⁰ *AQSH*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1955, D. 27. Marrëveshje mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës, mbi dhënien e një kredie nga Republika Popullore e Kinës Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 3 dhjetor 1955; *po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1958, D. 1, fl. 1-9. Korrespondencë ndërmjet Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH) dhe Partisë Komuniste të Kinës (PKK), mbi kërkesën e Shqipërisë për një kredi prej 55 milionë rublash dhe pranimin e kësaj kërkesë nga ana e Kinës, 7 tetor 1958.

⁵¹ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1954, D. 75. Protokoll i punimeve të komisionit të përbashkët të bashkëpunimit tekniko-shkencor mes Shqipërisë dhe Kinës, Tiranë, 3 dhjetor 1954.

⁵² Mëhilli, *From Stalin to Mao*, 99-109; *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1959, D. 18. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike. Raport i shokut Enver Hoxha mbi

rastin për të kërkuar dy vjet trajnim për 18 specialistë shqiptarë, të cilët do të shkonin të studionin në Kinë për përpunimin e mëndafshit dhe porcelanit.⁵³ Në këtë periudhë u shkëmbyen edhe produkte si pemët që mund të evitonin erozionin e tokës, të cilat Kina ofroi t'ia jepte Shqipërisë. Kina, nga ana tjetër, mori farat e limonit, portokallit, fikut dhe pemëve të tjera frutore. Shqipëria dërgoi edhe varietete të ndryshme perimesh si qepë, tranguj, shalqi, domate, fasule dhe fara ulliri nga rajoni i Beratit, së bashku me disa dokumente në lidhje me bonifikimin.⁵⁴

Megjithëse shkëmbimet me Kinën në këtë fazë ishin ende në një shkallë të kufizuar, duke arritur në rreth 20 milionë rubla në vitin 1958, ato kishin kuptim të madh politik për shqiptarët, të cilët e shihnin vendin e tyre në një pozitë më të barabartë me Pekinin në kontekstin e solidaritetit socialist, por edhe me kushte financiare shumë më të favorshme se ato me bllokun sovjetik, si norma interesi 50 për qind më të ulëta dhe periudha më të gjata shlyerjesh.⁵⁵ E megjithatë, edhe kjo sasi e vogël ndihme zbuloi mangësi në transport, pasi shpesh mallrat e dërguara nga Kina ruheshin në portet egjiptiane apo bullgare për shkak të mungesës së rrugëve të drejtpërdrejta detare midis Shqipërisë dhe Kinës.⁵⁶ Për shembull, kur Kina, në vitin 1958, kërkoi 20 mijë tonë naftë, Shqipëria nuk ishte në gjendje ta siguronte atë sepse pajisjet e saj

bisedimet me shokun Nikita Hrushov gjatë vizitës së tij në Shqipëri, Tiranë, 6 qershor 1959.

⁵³ *AQSH*, F. 490, V. 1955, D. 1159, fl. 7-13. Protokoll i punimeve të sesionit të parë të komisionit të bashkëpunimit tekniko - shkencor me Kinën, Tiranë, 25 shkurt 1954.

⁵⁴ *Po aty*, F. 490, V. 1956, D. 1065, fl. 2-217. Ministria e Ndërtimit drejtuar Kryeministrit. “Kërkesat tona për marrëdhënie tekniko-shkencore me Republikën Popullore të Kinës”, 16 janar 1956; *po aty*, F. 490, V. 1957, D. 1172, fl. 45-47. Relacion i ambasadës së Shqipërisë në Kinë, mbi materialet që Shqipëria i ka dërguar Kinës në kuadrin e bashkëpunimit tekniko-shkencor, Pekin, 23 mars 1957; Mbi pemët e ullinjve që Shqipëria i ka dërguar Kinës, shih kontributin e Sigrid Schmalzer, “Breeding New Knowledge at Home: The Case of the Albanian Olive Friendship Tree in China”, *Chinese Annals of History of Science and Technology*, vol. 3, no. 2 (2019):195-214.

⁵⁵ *AQSH*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1957, D. 268. “Protokoll mbi përdorimin nga Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë vitit 1957 të kredisë së akorduar nga Republika Popullore e Kinës si dhe protokollin e likuidimit të dërgesave të mallrave nga R. P. e Kinës në Shqipëri gjatë vitit 1957”, 8 mars 1957.

⁵⁶ *Po aty*, F. 503/Ministria e Tregtisë, V. 1958, D. 293, fl. 21-24. Letër e ambasadës së Shqipërisë në Pekin, dërguar Ministrisë së Tregtisë në Tiranë, 30 tetor 1958.

teknologjike nuk lejonin nxjerrjen e mjaftueshme të saj.⁵⁷ Përsëri, sasia totale e mallrave të shkëmbyera midis dy vendeve në këtë kohë ishte më e vogël se kapaciteti total i tonazhit të anijeve që lundronin në këto rrugë dhe për këtë arsye duhej të transportoheshin së bashku me mallrat e drejtuara në destinacione të tjera.⁵⁸

Pavarësisht këtyre problemeve, marrëdhëniet ekonomike me Kinën patën përfitimin anësor të ndërkombëtarizimit të mëtejshëm të profilit tregtar të Shqipërisë me vendet e tjera socialiste në Azi dhe vendet jashtë bllokut perëndimor. Në fakt, rritja e marrëdhënieve ekonomike dhe politike me Kinën i dha Shqipërisë mundësinë potenciale për të hapur kanale tregtare me Korenë, Vietnamin, Indonezinë dhe Ceilonin.⁵⁹ Megjithëse këto mundësi mbetën plotësisht të pashfrytëzuara për shkak të problemeve logjistike dhe infrastrukturore të Shqipërisë, por edhe për shkak të mungesës së diplomacisë tregtare aktive ndaj vendeve josocialiste, ato ishin një sinjal se Shqipëria mund të arrinte potencialisht tregje të tjera jashtë Europës Lindore, dhe kështu t'i ofronte Tiranës njëfarë autonomie tregtare.⁶⁰ Kjo bëhej edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh lidhjet e kufizuara transrajonale të Shqipërisë. Deri në vitin 1959, Italia ishte i vetmi vend në Europë jashtë bllokut të Europës Lindore dhe i vetmi vend perëndimor, me të cilin Shqipëria kishte një marrëveshje tregtare. Ndoshta kjo lidhet me faktin se para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore kompanitë italiane të industrisë së naftës dhe metalurgjisë kishin eksploruar dhe investuar në vend, por edhe sepse Italia ishte gjeografikisht dhe historikisht një burim i përshtatshëm i përparimeve teknologjike nga Perëndimi. Italia ishte gjithashtu i vetmi vend që shihej si një treg i mundshëm për eksportin e mallrave dhe importin e pajisjeve industriale nga Perëndimi.⁶¹

⁵⁷ *Po aty*, fl. 21-24.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 27-29. Raport i atasheut tregtar në ambasadën e Shqipërisë në Pekin, Dailan Buxheli, dërguar Ministrisë së Tregtisë në Tiranë, Pekin, 5 janar 1959.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 28.

⁶¹ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1958, D. 226. "Relacion i Ministrisë së Tregtisë (nga zëvendësministri Niazi Demi) dërguar shokut Enver Hoxha dhe shokut Mehmet Shehu, mbi mundësinë e zgjerimit të tregtisë me vendet kapitaliste". (Pa datë), 1958; shih po ashtu *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1958, D. 280-283; *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1957, D. 262. Lista e materialeve të marra nga Italia në kuadrin e marrëveshjes për reparacionet e luftës.

Animi drejt ndihmës kineze

Shpresat e shqiptarëve se marrëdhëniet ekonomike me sovjetikët dhe vendet e tjera të Europës Lindore do të përmirësoheshin dhe përfitimet ekonomike do të rriteshin, nuk po materializoheshin. Ata tashmë po përgatitnin në mënyrë aktive terrenin për një bashkëpunim më të ngushtë me Kinën. Vizita e Hrushovit në Shqipëri në maj të vitit 1959 përforcoi më tej bindjen e liderëve shqiptarë se aleanca me Kinën ofronte perspektiva më të mira për ndërtimin e llojit të socializmit që ata dëshironin dhe ndërmarrjen e një rrugëtimit ekonomik që për ta mendohej se do të rriste pavarësinë ekonomike të Shqipërisë dhe do të përforconte qeverisjen politike të Partisë së Punës. Në Shqipëri, Hrushovi, me formulën “do ta shohim edhe këtë”, hodhi poshtë shumicën e kërkesave ekonomike të Shqipërisë për investime në industri. Më e rëndësishmja, Hrushovi kritikoi idenë e ndjekjes së një modeli ekonomik autarkik, që do të thotë se “Shqipëria nuk duhet të synojë të prodhojë gjithçka”.⁶² Hrushovi theksoi, gjithashtu, rëndësinë e marrjes në konsideratë të tregjeve ndërkombëtare kur vendosej për investimet ekonomike.

Nuk është e qartë nëse ka pasur ndonjë debat brenda institucioneve vendimmarrëse shqiptare për autarkinë si model, por ato ishin në kërkim të mbështetjes në forcat e veta – në këtë qëndrim dhanë kontribut edhe kinezët – si e vetmja mënyrë për të penguar që marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare të ndiknin negativisht në agjendën e brendshme politike të regjimit. Ndërkohë që Bashkimi Sovjetik e shihte ekonominë e vogël të Shqipërisë si pjesë përbërëse të tregut ekonomik socialist europian më të integruar (sado i kufizuar ky integrim) dhe i jepte përparësi një modeli ekonomik që do ta bënte Shqipërinë pjesë të këtij integrimi, liderët shqiptarë kërkuan një model ekonomik autonom që mund të synonte në vetëmbështetje, e që do ta mbronte Shqipërinë nga paparashikueshmëria e ngjarjeve ekonomike dhe politike në Europën Lindore si protestat e vitit 1956 në Poloni dhe Hungari që kërcënuan sundimin e Partisë Komuniste.

Këmbëngulja dhe ndihma sovjetike në zhvillimin e industrisë së lehtë rezultoi në një numër fabrikash të rëndësishme, të cilat prodhoin mallra konsumi që hynë në prodhim në vitet 1960-1961 ose ishin në fazat

⁶² *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1959, D. 18. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, Tiranë, 6 qershor 1959.

e fundit të ndërtimit, si, ndër të tjera, fabrikat e përpunimit të mishit, fabrikat e prodhimit të duhanit, konservimin e frutave dhe perime, fabrika e prodhimit të pllakave, fabrika e sheqerit, fabrika e prodhimit të alkoolit dhe verës.⁶³ Ndërtimi i suksesshëm i këtyre projekteve i lejoj Shqipërisë të shpërndante më shumë burime për projekte të reja dhe t'i drejtohej Kinës për ato që lidheshin me industrinë e rëndë. Në vitin 1959, planifikuesit ekonomikë shqiptarë arritën në përfundimin se “nga këndvështrimi i zhvillimit industrial, vendi ynë mbetet shumë prapa demokracive të tjera popullore, veçanërisht në fusha të tilla si metalurgjia dhe industria kimike”.⁶⁴ Pra, ashtu si në Kinë, edhe për Shqipërinë zhvillimi i metalurgjisë, industria kimike (për plehrat bujqësore) dhe nxjerrja dhe përpunimi i naftës u bënë prioritetet kombëtare.

Nxjerrja e naftës ishte një industri për të cilën planifikuesit ekonomikë shqiptarë kishin shpresa të mëdha. Së pari, Shqipëria vlerësohej se kishte rezerva të mëdha nafte të paeksploruara, ndërkohë që kishte disa kërkesa ndaj saj nga Europa Lindore dhe Perëndimore për import nafte. Në vitin 1959, Gjermania Lindore kërkoi një rritje të sasisë së naftës nga Shqipëria, duke pohuar se “do të ishte e gatshme të blinte sasi të mëdha në të ardhmen”.⁶⁵ Gjatë një panairi ndërkombëtar në qytetin italian të Barit në shtator të vitit 1959, ku Shqipëria për arsye të paqarta ishte i vetmi vend i Europës Lindore që mori pjesë, presidenti i ENI-it (kompania italiane e naftës dhe e gazit), Enriko Matei (Enrico Mattei), raportohet të ketë kërkuar të blinte “çdo sasi nga 200 mijë tonë naftë e lart” në vit dhe pohoi gatishmërinë për të ofruar teknologji për nxjerrjen

⁶³ *Po aty*, F. 499, V. 1961, D. 454. “Korrespondencë e Ministrisë së Industrisë me Ministrinë e Ndërtimit mbi kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të fabrikave të përpunimit të rrushit Korçë, Përmet, si dhe mbi sigurimin e ujit për fabrikat e rrushit në Këlcyrë, Tiranë etj. (Pasqyra mbi grafikun dhe materialet e fabrikës së mishit Berat, Pogradec, Korçë etj.). Vendim nr. 432 dt. 4.12.1961 i Këshillit të Ministrave mbi ngritjen e fabrikës së mishit në qytetin e Lushnjës”. Dokumentet dhe relacionet në këtë dosje datojnë nga 23 janari deri më 20 dhjetor të vitit 1961; *po aty*, F. 499, V. 1960, D. 606 dhe D. 609. “Pasqyra e gjendjes së kontratave dhe projekteve për objektet industriale që mbarojnë në vitin 1960”. (Pa datë), 1960.

⁶⁴ *Po aty*, F. 495, V. 1959, D. 2, fl. 33. Relacion i Komisionit të Planit të Shtetit me titull “Mbi disa çështje të Ekonomisë së Republikës Popullore të Shqipërisë”, Tiranë, 17 maj 1959.

⁶⁵ *Po aty*, F. 503/Ministria e Tregtisë, V. 1959, D. 252, fl. 1-2. Letër e zëvendësministrit të Tregtisë së Jashtme të Gjermanisë Lindore, Erwin Kerber, dërguar Ministrisë së Tregtisë së Shqipërisë, 19 mars 1959.

dhe përpunimin e saj.⁶⁶ Megjithëse marrëveshjet përfundimtare nuk u arritën, potenciali që mund të kishte nxjerrja e naftës për ekonominë e Shqipërisë ishte i qartë në një kohë kur eksportet e Shqipërisë drejt vendeve perëndimore në vitin 1959 pritej të arrinin vetëm 6,5 milionë rubla.⁶⁷

Por nxjerrja dhe përpunimi i naftës kërkon teknologji të avancuara – teknologji që Shqipëria zotëronte vetëm në një shkallë të kufizuar. Që nga viti 1954, sovjetikët kishin kundërshtuar zhvillimin e industrive të lidhura me naftën në shkallën e kërkuar nga Shqipëria, sepse, siç pohonin ata, nafta shqiptare kishte një përqindje të lartë sqfuri dhe nuk mund të shitej lehtë në tregjet ndërkombëtare.⁶⁸ Për shkak të mungesës së investimeve dhe pajisjeve të përshtatshme, në fund të planit të dytë pesëvjeçar 1956-1960, prodhimi vjetor i naftës mezi i kaloi 500 mijë tonë, krahasuar me një objektiv të planifikuar prej dy milionë tonësh deri në vitin 1960.⁶⁹ Në fund të vitit të dytë të planit pesëvjeçar 1956-1960 në thelb të gjithë treguesit e prodhimit industrial treguan deficite në raport me objektivat e planit për shkak të mungesës së pajisjeve të mjaftueshme teknologjike dhe aftësive të nevojshme për të eksploruar dhe nxjerrë minerale. Edhe nxjerrja dhe përpunimi i kromit, i cili u zbulua se ishte në sasi të mëdha në tokën shqiptare, ishte i kufizuar për shkak të mungesës së pajisjeve.⁷⁰

Nga viti 1945 deri në vitin 1960, totali i kredisë që të gjitha vendet e Europës Lindore (përjashtuar Jugosllavinë) i dhanë Shqipërisë, së bashku me kreditë sovjetike dhe kineze, llogaritet të jetë rreth 1,2

⁶⁶ *Po aty*, F. 503/Ministria e Tregtisë, V. 1959, D. 270, fl. 7-11, 23. Relacion i ministrit Fuqiptotë Koço Prifti, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme. “Relacion mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në panairin e Barit”. Romë, 28 shtator 1959.

⁶⁷ *Po aty*, F. 503/Ministria e Tregtisë, V. 1959, D. 315. “Informacion mbi eksportin me Perëndimin për vitin 1959”. (Pa datë, 1959). Në këtë dokument nuk thuhet se përse në statistika vlerat e shkëmbimeve jepen në rubla, por për një shpjegim mbi këmbimin valutor mes rublës dhe dollarit deri në vitin 1960 shih Marcin R. Wyczalkowski, “The Soviet Price System and the Ruble”, in *International Monetary Fund Staff Papers*, vol.1, no. 2 (June 1960), 203-223.

⁶⁸ *AQSH*, F. 490, V. 1954, D. 223, fl. 2-6. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, Tiranë, 2 korrik 1954.

⁶⁹ *Po aty*, F. 495, V. 1960, D. 18, fl. 23. Raport i Komisionit të Planit të Shtetit, Tiranë, 13 nëntor 1959.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 36-78. Raport i Komisionit të Planit të Shtetit “Mbi përfundimin e planit pesëvjeçar”, Tiranë, 10 nëntor 1959.

miliardë rubla për periudhën 1945-1960, ku pjesa e Kinës është rreth 6,5 për qind.⁷¹ E megjithatë, standardet ekonomike dhe të jetesës së Shqipërisë mbetën shumë më të ulëta se në cilindo prej këtyre vendeve, përveç Kinës. Ky zhvillim i dobët u pasqyrua më së miri në një dokument të Ministrisë së Tregtisë, ku vihej në dukje se si gjatë planit të dytë pesëvjeçar 1956-1960, deri “edhe cilësia e këpucëve të prodhuara në Shqipëri është e dobët”.⁷² Përqendrimi i vëmendjes në zhvillimin e mundshëm të industrisë së rëndë, së bashku me planifikimin e dobët dhe kapacitetet e kufizuara infrastrukturore të Shqipërisë, janë faktorë të rëndësishëm që çuan në neglizhencën e nevojave më imediate si ato që lidhen me prodhimin e mallrave të konsumit. Rezultati ishte se deficitit tregtar i Shqipërisë mbeti mjaft i lartë. Në përlllogaritjet e Ministrisë së Tregtisë, të cilat bazoheshin në materialet dhe artikujt e importuar për projektet e tyre ekonomike, si dhe të dhënat për tregtinë me Kinën dhe Perëndimin, totali i importeve të Shqipërisë gjatë viteve 1956-1960 arriti në 799,16 milionë rubla, ndërsa eksporti total arriti në vetëm 425,1 milionë rubla.⁷³ Vetëm në vitin 1960 kishte një deficit të bilancit të pagesave prej 46,3 milionë rublash.⁷⁴ Të gjithë këta faktorë ndikuan në një politikë ekonomike në Shqipëri që i jepte përparësi zhvillimit industrial që do të mundësonte përpunimin e mineraleve në vend dhe prodhimin e artikujve me vlerë të konsiderueshme për tregjet ndërkombëtare. Dhe për këtë Shqipëria kishte nevojë për investime në industri që vetëm Kina, në këtë fazë, premtoi se do t’i siguronte.

Në Tiranë, të dhënat statistikore në lidhje me ndihmën ndërkombëtare të Bashkimit Sovjetik përforcuan më tej ndjenjën e neglizhencës nga Moska ndaj prioriteteve ekonomike të Shqipërisë. Pra, dokumentet e KNER-it, por edhe të ambasadave të ndryshme shqiptare në vende të ndryshme socialiste, tregonin se si Kampi Socialist europian, së bashku me Bashkimin Sovjetik, po u jepnin një ndihmë të madhe një

⁷¹ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 376. Relacion i Ministrisë së Tregtisë. Listat e plota të kredive që i janë dhënë Shqipërisë gjatë periudhës 1945-1960, Tiranë, 2 qershor 1961.

⁷² *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1956, D. 150. Raport i Ministrisë së Tregtisë mbi tregtinë në periudhën 1956-1960, Tiranë, 14 nëntor 1960.

⁷³ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 362, fl. 1. Relacion i Ministrisë së Tregtisë “Dinamikat e eksporteve të Shqipërisë gjatë planit të dytë pesëvjeçar, 1956-1960”, Tiranë, (Pa datë).

⁷⁴ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 375, fl. 31-36. Relacion i Ministrisë së Tregtisë mbi bilancin e pagesave për vitin 1960, Tiranë, 8 maj 1961.

sërë vendeve “kapitaliste” në Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine me një total që vlerësohej në më shumë se 10 miliardë rubla deri në fillim të vitit 1960.⁷⁵ Raportet lanë të kuptohet se Bashkimi Sovjetik po ndihmonte një sërë vendesh, disa prej tyre jokomuniste, ndërsa refuzonte të mbështeste planet ekonomike të Shqipërisë socialiste. Në një dokument tjetër të KNER-it të hartuar në rusisht, prodhimi industrial i Shqipërisë parashikohej të mbetej i ulët të paktën deri në vitin 1965.⁷⁶ Kjo ishte e gjitha në një kohë kur Tirana po përgatitej të zbatonte planin e tretë pesëvjeçar 1961-1965, i cili e kishte rritur numrin e projekteve industriale të planifikuara. Në këtë situatë, udhëheqësit shqiptarë arritën në përfundimin se të gjitha planet e tyre për zhvillimin ekonomik të vendit nuk u pasqyruan në planifikimin e KNER-it dhe në ndihmën ekonomike sovjetike për Shqipërinë.

Në dritën e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme me sovjetikët, në vitin 1959, vetëm një muaj përpara se Hrushovi të vizitonte Shqipërinë dhe pas kërkesës së Hoxhës drejtuar Maos, një delegacion shqiptar i kryesuar nga një prej shokëve më të besuar të Hoxhës, Hysni Kapo, u takua me Maon dhe vizitoi Kinën për një muaj me synimin e qartë të “studimit të përvojës së ndërtimit të socializmit në Kinë”.⁷⁷ Kryeministri kinez, Zhou Enlai i tha Kapos se Kina i jepte përparësi zhvillimit të industrisë dhe theksoi se “Shqipëria ka kërkuar shumë pak nga Kina... në

⁷⁵ *Po aty*, F. 490, V. 1961, D. 1023, fl. 2-9. Relacion i përfaqësuesit të Shqipërisë në KNER, Vasil Kati, dërguar zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Koço Theodhosi, më 19 prill 1961. Informacion mbi ndihmën që vendet socialiste të Europës u kanë dhënë vendeve të pazhvilluara kapitaliste në Azi, Afrikë dhe Amerikën Latine. Deri më 1 janar 1961, kursi i këmbimit mes dollarit amerikan dhe rublës sovjetike ishte 1 me 4. Shih për këtë çështje Kang Chao, “Pitfalls in the Use of China's Foreign Trade Statistics”, *The China Quarterly*, No. 19 (Jul. - Sep., 1964): 47-65; Mbi kursin e këmbimit mes rublës sovjetike dhe yuan-it kinez gjatë viteve 1950, shih Kang Chao and Feng-hwa Mah, “A Study of the Rouble-Yuan Exchange Rate”, *The China Quarterly*, No. 17 (Jan. - Mar., 1964): 192-204.

⁷⁶ *AQSH*, F. 14/KNER, V. 1961, D. 21. “Të dhëna të ndryshme statistikore nga vendet socialiste dhe kapitaliste në rusisht, për vitet 1937-1965, që zëvendëspërfaqësuesi i RPSH pranë KNER-it (Vasil Kati) i ka dërguar sekretarit të KQ të PPSH, Haki Toska”. Moskë, 21 janar 1961.

⁷⁷ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1959, D. 1. Korrespondencë ndërmjet PPSH-PKK, Tiranë, 12 mars 1959; *po aty*, F. 14/AP, V. 1959, D. 2, D. 4 - D. 18. Shënime nga vizita dhe takimet e delegacionit të PPSH-së, kryesuar nga Hysni Kapo, prill-maj 1959.

të ardhmen, ne mund t'ju ndihmojmë edhe më shumë".⁷⁸ Kapo raportoi se kishte parë në Kinë një rritje të përgjithshme të prodhimit ekonomik, me komunat e popullit që kishin zgjidhur çështjen e furnizimeve ushqimore, duke e portretizuar prodhimin ekonomik në sasi "madhështore".⁷⁹ Kapo u kthye nga Kina me disa dokumente, të cilat për liderët shqiptarë synonin shprehimisht të ishin udhërrëfyesit për ndërtimin e sistemit socialist të Shqipërisë.⁸⁰ Veçanërisht të rëndësishme ishin një sërë dokumentesh në lidhje me ndërtimin e komunave popullore (kooperativat e bashkuara) dhe propagandën politike, arsimin dhe mobilizimin masiv në zonat rurale – këto të fundit do të shërbenin si në Kinë, ashtu edhe në Shqipëri si një mjet për rritjen e produktivitetit. Zyrtarët e partisë u udhëzuan t'i studionin këto dokumente dhe të shihnin se çfarë "nga përvoja kineze mund të zbatohet në Shqipëri".⁸¹

Është interesante se nuk ka asnjë shenjë që shqiptarët të kenë ditur shkallën e pasojave dramatike të Hovit të Madh Përpara (Great Leap Forward – Dà yuèjìn), një fushatë e nisur nga Mao në verën e vitit 1958 që synonte të arrinte në Kinë kapacitetin industrial perëndimor, por edhe sovjetik.⁸² Arkivat e disponueshëm në Shqipëri nuk pasqyrojnë debate brenda lidërshiptar në lidhje me pasojat në Kinë të Hovit të Madh Përpara. Përkundrazi, ambasada shqiptare në Pekin, në prill të vitit 1960, raportonte se kjo fushatë i kishte sjellë Kinës "arritje të papara në historinë e saj" dhe se i gjithë zhvillimi ekonomik i Kinës bazohej në vendosjen e industrisë si "sektori udhëheqës" i ekonomisë.⁸³ Zyrtarët kinezë, nga ana e tyre, pranuan disa gabime, por ata i minimizuan ato si gabime të lidhura me "planifikimin e dobët" dhe vendosjen e "objektivave

⁷⁸ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1959, D. 2. Shënime nga takimi i shokut Hysni Kapo me udhëheqësit kinezë shokët Çu Enlai dhe Teng Hsiaoping (Zhou Enlai dhe Deng Xiaoping), Pekin, 15 prill 1959.

⁷⁹ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1959, D. 6, fl. 2. Raport i shokut Hysni Kapo mbi eksperiencën e Partisë Komuniste Kineze.

⁸⁰ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1959, D. 12-D. 18.

⁸¹ *Po aty*, F.14/AP-MPKK, V. 1959, D. 6.

⁸² John King Fairbank and Merle Goldman, *China: A New History*, Second Enlarged Edition (New Haven; Harvard University Press, 2006), 365-382; Zhihua Shen and Yafeng Xia, "The Great Leap Forward, the People's Commune and the Sino-Soviet Split", *Journal of Contemporary China*, vol. 20, no. 72 (2011): 861-880.

⁸³ *AQSH*, F. 14/AP-Strukturë (Str.), V. 1960, D. 667, fl. 24-31. Raport i ambasadorit të Shqipërisë në Pekin, Mihal Prifti, mbi disa çështje të ndërtimit të socializmit në Kinë, Pekin, 18 prill 1960.

jorealiste”.⁸⁴ Disa raporte të ambasadës shqiptare në Pekin gjatë vitit 1960 duket se kanë qenë krejtësisht jashtë kontaktit me realitetin, megjithëse nuk është e qartë nëse kjo ishte e qëllimshme. Kështu në ato raporte Kina portretizohet si një vend që kalon “nga një arritje në tjetrën... [nga] ... një fitore në tjetrën” me prodhime ekonomike në rritje në të gjithë sektorët, përfshirë në bujqësi.⁸⁵ Është e qartë se liderët shqiptarë kishin rënë (me dëshirë) viktimë e propagandës kineze për mrekullinë ekonomike të Hovit të Madh Përpara. Megjithëse arkivat shqiptarë duket se pasqyrojnë ligjëratën zyrtare kineze mbi fushatën e Hovit, është e mundur që lidhshipi shqiptar ta ketë konsideruar të panevojshme të debatonte apo kundërshtonte një fushatë të tillë në një kohë kur Kina po tregonte gatishmëri për të ndihmuar projektet ekonomike të Shqipërisë.

Megjithatë, perceptimi i Shqipërisë për Hovin e Madh është kontradiktor. Fillimisht u mendua të rriste prodhimin industrial të Kinës, por në verën e vitit 1960, megjithëse me një vonesë të caktuar, ndikoi në marrëdhëniet ekonomike të Shqipërisë me Kinën. Atasheu tregtar shqiptar në Pekin në verën e vitit 1960 shkroi se “në fillim kinezët pranojnë [kërkesat] për të shpëtuar fytyrën, dhe më pas thërrasin dhe nxjerrin lloj-lloj justifikimesh se nuk janë në gjendje të japin atë që është rënë dakord” – një shenjë kjo se situata ekonomike në Kinë ishte më pak rozë sesa përshkruhej. Në korrik të vitit 1960, një raport nga Pekini pohonte se “nuk ka më atë predispozicion për të na ndihmuar me çdo kusht”.⁸⁶ Asnjë nga këto çështje nuk lidhej në mënyrë eksplicite me Hovin e Madh, i cili nuk u përmend kurrë. Në fakt, edhe kur disa ndërprerje në prodhimin ekonomik kinez u bënë të qarta, atasheu shqiptar në Pekin u sigurua nga funksionarë të lartë kinezë se “marrëdhëniet me Shqipërinë do të zhvillohen në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara”.⁸⁷ Në të njëjtin vit, pra më 1960, Shqipëria eksportoi në

⁸⁴ *Po aty*, fl. 25-30.

⁸⁵ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1960, D. 667. Raporte të ambasadës së Shqipërisë në Pekin, 8 shkurt 1960 - 9 korrik 1960.

⁸⁶ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 333, fl. 22. Raport i ambasadës së Shqipërisë në Pekin, korrik 1960.

⁸⁷ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1961, D. 539, fl. 9-10. Informacion i atasheut tregtar shqiptar në Pekin, Halil Zeneli, mbi takimin e tij me përgjegjësën për vendet socialiste në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kinës, Pekin, 5 gusht 1961.

Kinë, ndër të tjera, rreth 23 mijë tonë krom, 3,5 mijë tonë bakër dhe rreth 12 mijë tonë naftë.⁸⁸

Shqetësimet e mundshme në lidhje me Hovin e Madh u lanë gjithsesi në hije nga ndarja kino-sovjetike në verën e vitit 1960. Atë vit, në fakt, çarjet në Kampin Komunist u shfaqën haptazi kur shpërthyen diskutime të nxehta dhe mosmarrëveshje të hapura midis Moskës dhe Pekinit në takimet e partive komuniste, në forume nga Pekini në Bukuresht dhe përfundimisht në Moskë në nëntor të vitit 1960.⁸⁹ Në fillim, Tirana u tregua e kujdesshme ndaj mosmarrëveshjeve kino-sovjetike, por më pas refuzoi të mbështeste qëndrimin e Moskës kundër Pekinit dhe përfundimisht në Moskë mori anën e Kinës.⁹⁰ Për Kinën, Shqipëria u shfaq si një aleat i rëndësishëm politik në Europë – i vetmi – në një kohë kur blloku sovjetik po bashkohej kundër Pekinit. Si rezultat, Bashkimi Sovjetik u kundërpërgjigj duke ndërprerë ndihmën për Shqipërinë.⁹¹ Ndërprerje të ngjashme pasuan shpejt me vendet e Europës Lindore. Në vitin 1960, raportet që vinin nga ambasadat shqiptare në Moskë, Pragë, Varshavë dhe Budapest po zbulonin të gjitha antagonizmin në rritje të pozicioneve nga të dyja palët: këmbënguljen e Tiranës që tregtia midis vendeve socialiste të bazohej në parimet e përfitimit të ndërsjellë dhe solidaritetit socialist dhe vëmendjen e papritur dhe të shtuar të vendeve të Bllokut Socialist europian për cilësinë dhe çmimin e produkteve shqiptare, së bashku me kërkesat në rritje për trajtimin më të mirë të specialistëve të vendeve të tyre në Shqipëri.⁹²

⁸⁸ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 333, fl. 27-29. Raport i atasheut tregtar në Pekin, 26 tetor 1960.

⁸⁹ Lorenz Lüthi, *The Sino-Soviet Split. Cold War in the Communist World* (Princeton and Oxford: Princeton University Press, 2008).

⁹⁰ Ylber Marku, “Communist Relations in Crisis: The End of the Soviet-Albanian Relations, and the Sino-Soviet Split, 1960-61”, *The International History Review*, vol. 42, no. 4, (2020): 813-832; Mbi ndarjen kino-sovjetike, mes shumë autorëve, shih Danhui Li and Yafeng Xia, *Mao and the Sino-Soviet Split, 1959-1973. A New History* (New York and London: Lexington Books, 2018); Lüthi, *The Sino-Soviet Split*.

⁹¹ *AQSH*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1961, D. 256. Protokoll i bisedimeve në vitin 1961, mes delegacionit ekonomik të Shqipërisë dhe atij të Bashkimit Sovjetik, zhvilluar në Moskë; *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1961, D. 260. Informacion i delegacionit tonë tregtar që shkoi në Moskë mbi divergjencat me palën sovjetike në lidhje me marrëveshjet ekonomike për vitin 1961, dhe për periudhën 1961-1965.

⁹² Shih gjithashtu dokumentet e Ministrisë së Tregtisë, në *AQSH*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 228, D. 240, D. 241, D. 278, D. 336.

Në këtë situatë Kina i erdhi në ndihmë Shqipërisë, duke e shpërblyer Tiranën për mbështetjen e saj ndaj pozicioneve të Pekinit kundër sovjetikëve. Po kështu, kur gjatë vitit 1960 Shqipëria u godit nga mungesa në furnizimin me drithë pjesërisht për shkak të përmbytjeve të një viti më parë, vetëm Kina pranoi dhe në vitin 1960 dërgoi më shumë se 45 mijë tonë drithë, 30 mijë tonë prej të cilave u blenë me dollarë në Francë, dhe pjesa tjetër në mënyrë paradoksale u ble në Bashkimin Sovjetik.⁹³ Në tetor të vitit 1960 Kina pranoi një kërkesë për të dhënë 140 mijë tonë grurë shtesë, që do të konsideroheshin si kredi pa interes, të ndara midis grurit dhe orizit, dhe 1,5 milionë dollarë në valutë, qëllimi i së cilës është i paqartë.⁹⁴ Ndihma për Shqipërinë në një kohë kur Kina u godit nga uria mund të duket e paarsyeshme, por, për Pekinin, ndihma ekonomike për Shqipërinë kishte përfitimin potencial politik afatgjatë të të pasurit ende një bastion në Europën Lindore edhe pas ndarjes kino-sovjetike.⁹⁵

Karakteristika të shkëmbimeve ekonomike në fillim të periudhës së partneritetit

Pas ndarjes shqiptare-sovjetike në vitet 1960-1961, Bashkimi Sovjetik tërhoqi të gjithë specialistët nga Shqipëria dhe ndërpreu ndihmën ekonomike. Më pas, Kina vendosi t'i jepte prioritet ndihmës ekonomike ndaj Shqipërisë, duke e bërë atë një "detyrim ndërkombëtar".⁹⁶ Me një sërë marrëveshjesh midis viteve 1959 dhe 1961, Pekini u angazhua për të ofruar ndihmë ekonomike për Shqipërinë për planin e tretë pesëvjeçar 1961-1965 me kushte më të mira se ato të negociuara më parë me Bashkimin Sovjetik, si interesi vjetor 1 për qind

⁹³ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 332, fl. 5. Li Xiannian për Abdyl Këllezin, Pekin, 21 maj 1960; *po aty*, F. 503-504, V. 1960, D. 333, fl. 27-29. Raport i atasheut tregtar në Pekin, 26 tetor 1960.

⁹⁴ *Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme*, Fondi MPJ (më tej: *AMPJ*), Viti (më tej V.) 1961, Dosja (më tej: D.) 165, fl. 70-72. Relacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë "Mbi marrëdhëniet e vendit tonë me Kinën gjatë vitit 1961". (Pa datë, 1961).

⁹⁵ Marku, "Communist Relations in Crisis"; Marku, "Shifting Alliances".

⁹⁶ Tao Chen, "East German pragmatism, China's policy of differentiation, and Soviet miscalculation: Hermann Matern's 1961 trip to China revisited", *Cold War History*, Vol. 19, no. 1 (2018): 85-99.

për kreditë, një periudhë më e gjatë shlyerjeje (kryesisht përmes marrëveshjeve të kleringut), çmime të përshtatshme për shkëmbimet tregtare të Shqipërisë dhe investime në projektet industriale të Shqipërisë me interes prioritar.⁹⁷ Në janar të vitit 1961, Kina zëvendësoi ndihmën sovjetike dhe dha 500 milionë rubla për planin e tretë pesëvjeçar të Shqipërisë, 1961-1965, e cila ishte shtesë e 55 milionëve që kishin dhënë për vitin 1961.⁹⁸ Ky plan i ri, i pari që do të zbatohet pothuajse tërësisht me ndihmën kineze, sipas liderëve shqiptarë do të lejonte që Shqipëria të “hynte në një epokë të re, atë të ndërtimit të bazës teknike dhe materiale për ndërtimin e socializmit”.⁹⁹ Ndhimja e Kinës prej 555 milionë rublash u drejtua pjesërisht për zbatimin e 24 projekteve industriale dhe tejkaloi me 24 milionë rubla ndihmën që qeveria shqiptare kishte negociuar (por nuk kishte marrë) nga sovjetikët dhe vendet e Europës Lindore të marra së bashku.¹⁰⁰ Kina gjithashtu dha garanci për furnizime ushqimore për pesë vitet e ardhshme nëse Shqipërisë do t’i nevojitej.¹⁰¹

Të dyja palët vendosën të ruajnë rublën si monedhë referuese, gjë që tregon se infrastruktura financiare sovjetike arriti përtej bllokut sovjetik në kuptimin më të ngushtë dhe mbeti me ndikim për të dyja vendet edhe pas ndarjes me Moskën.¹⁰² Rritja e shkëmbimeve me Kinën fuqizoi flotën tregtare të Shqipërisë, e cila u bë e aftë të lundronte në

⁹⁷ *AQSH*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1961, D. 309. Marrëveshje mes Shqipërisë dhe Kinës mbi shkëmbimet tregtare reciproke dhe bilancin e pagesave mes dy vendeve për periudhën 1961-1965, 23 prill 1961; *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1961, D. 311. Marrëveshje mes Shqipërisë dhe Kinës mbi kreditë që Kina i jep Shqipërisë për periudhën 1961-1965, dokument datuar 1961; Shih gjithashtu dokumentet në *po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1961, D. 312, D. 314, D. 315, D. 321.

⁹⁸ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1961, D. 1, fl. 7-13. Shënime nga takimi i Spiro Kolekës me Zhou Enlai-n, në Pekin, më 30 janar 1961.

⁹⁹ *Po aty*, F. 14/ AP-OU, V. 1961, D. 25, fl. 1. Fjalimi i Enver Hoxhës në Kongresin IV të PPSH-së në vitin 1961.

¹⁰⁰ *AMPJ*, V. 1961, D. 168/2, fl. 16-24. Relacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi ndihmën ekonomike që Kina i ka dhënë Shqipërisë për planin e dytë pesëvjeçar 1961-1965, qershor 1961.

¹⁰¹ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1961, D. 29, fl. 5-6. Procesverbal i punimeve të Plenumit të 22-të të Kongresit të Tretë të PPSH-së, më 6 shkurt 1961.

¹⁰² *Po aty*, F. 503/Ministria e Tregtisë, V. 1958, D. 293, fl. 33-35. Ministria e Tregtisë (letër e ministrit Kiço Ngjela) drejtuar atashet tregtar në Pekin, Dalian Buxheli, 2 prill 1959; Kjo ndodhte shpesh brenda Kampit Komunist. Shih Chao, “Pitfalls in the Use of China's Foreign Trade Statistics”.

rrugët tregtare globale detare. Në vitin 1961, flota tregtare u modernizua me dy anije të mëdha, me një kapacitet përkatësisht 5 mijë dhe 12 mijë tonë, për të cilat Kinës iu kërkua të jepte asistencë teknike dhe trajnime për ekuipazhet.¹⁰³ Një nga këto, ishte një anije mallrash transoqeanike e blerë në Itali dhe udhëtimi i saj i parë drejt Kinës zgjati njëzet ditë, duke shënuar herën e parë që një anije shqiptare kalonte tranzit në Kanalin e Suezit. Në Shqipëri, porti i Durrësit, i cili kishte qenë porti kryesor i tregtisë me Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore, vazhdoi si qendra kryesore e tregtisë së Shqipërisë dhe u hartuan plane për ta zgjeruar atë me ndihmën e Kinës.

Lista e projekteve me të cilat Kina ishte zotuar të ndihmonte shkoi kryesisht në favor të industrisë. Ndër këto projekte të reja ishte një kombinat i madh industrial kimik metalurgjik, i cili përfshinte fabrikën e ferrokromit, të bakrit dhe të superfosfatit, së bashku me një fabrikë të përpunimit të çelikut, në fshatin e vogël rural të Laçit. Kjo zonë industriale ishte studiuar nga një ekip i përbashkët ekspertësh sovjetikë, çekoslovakë dhe shqiptarë, të cilët kishin përfunduar një studim paraprak në vitin 1958, ndërsa tani Kina vendosi ndërtimin e saj.¹⁰⁴ Kina dha asistencë edhe për fazën e parë të ndërtimit të Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, i njohur si fabrika e ushqimit të metalurgjisë pasi u planifikua të bëhej fabrika më e madhe e prodhimit të çelikut në vend; ndërtimin e një fabrike bakri në qytetin e Shkodrës; ofroi ndihmë për ekspeditat minerare dhe gjeologjike dhe vendosjen e bashkëpunimit tekniko-shkencor me institutet kërkimore në Kinë. Kina në përgjithësi u angazhua për investime të mëtejshme në ndërtimin e një industrie të fortë metalurgjike dhe ofrimin e teknologjisë për nxjerrjen e naftës. Për Shqipërinë, ndihma kineze pati përfitimin, ndër të tjera, të ofrimit të projekteve industriale me një kosto më të ulët “se ato [të ndërtuara] me vendet e tjera”.¹⁰⁵

Pas vitit 1961, ndërsa ndihma ekonomike kineze për Shqipërinë kontribuoi në synimin e Shqipërisë për t’u mbështetur në forcat e veta,

¹⁰³ AMPJ, V. 1961, D. 168, fl. 6. Letër e ministrit të Tregtisë, Kiço Ngjela, drejtuar ambasadës së Shqipërisë në Kinë, 22 qershor 1961.

¹⁰⁴ AQSH, F. 490, V. 1958, D. 521. Relacion i Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave drejtuar Këshillit të Ministrave, mbi projektin e ndërtimit të fabrikës së ferrokromit dhe kombinatit të superfosfatit në zonën e Laçit, 5 shtator 1958.

¹⁰⁵ Shih gjithashtu dokumentet e mbledhjes së qeverisë, 16 maj 1961, në *po aty*, F. 490, V. 1961, D. 24, fl. 4.

a jo mbeti gjithashtu e ndërthurur me flukset ekonomike dhe furnizimet nga pjesa tjetër e botës. Ndërtimi i fabrikës së plehrave kimike në Fier, për shembull, u mbështet edhe në teknologjinë nga Italia – afërsia gjeografike dhe lidhjet historike lehtësuan aksesin e kufizuar të Shqipërisë në industrinë moderne kimike të Italisë, megjithëse dallimet politike penguan bashkëpunimin dhe shkëmbimet intensive ekonomike. Një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm që Kina u angazhua për të ndihmuar ishte ndërtimi i hidrocentraleve përgjatë lumit Drin në veri të Shqipërisë.¹⁰⁶ Nga pajisjet në ndërtim, si kamionët për heqjen dhe transportin e sedimenteve, deri tek turbinat për prodhimin e energjisë elektrike u negociuan dhe u importuan nga Europa Lindore dhe Perëndimore – përfshi Mbretërinë e Bashkuar, një vend në atë kohë pa marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë. Në vitin 1961 Kina bleu një sërë artikujsh nga vendet e treta për t'i dërguar në Shqipëri, si plehurat kimike nga Bullgaria, vaj ulliri nga Tunizia, drithëra nga Kanadaja dhe artikuj të tjerë industrialë nga Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania Perëndimore, duke importuar në total më shumë se 9 milionë rubla mallra nga vendet e tjera socialiste dhe më shumë se 11 milionë rubla nga vendet kapitaliste.¹⁰⁷ Bilanci tregtar i Shqipërisë me Kinën do të vazhdonte të ishte negativ, ashtu siç kishte qenë me të gjitha vendet e Europës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik. Për shembull, në vitin 1962 Shqipëria llogariti se eksportet drejt Kinës arrinin në rreth 14 milionë rubla mallra, ndërsa në të njëjtin vit, importet nga Kina, përfshirë mallrat e blera nga vendet e treta, arritën në gati 52 milionë rubla.¹⁰⁸

Në këtë kontekst, megjithatë, mangësitë ekonomike të Kinës dhe Shqipërisë u shfaqën plotësisht. Ato duken se ishin strukturore, pasojë e prapambetjes së vetë Shqipërisë, njohurive të pakta të zyrtarëve të saj për menaxhimin dhe prirjes së saj ndaj neglizhencës sesa si pasojë e vendimeve të qëllimshme nga lidërsihipi i lartë. Nga ana shqiptare, disa aspekte të marrëdhënieve ekonomike me Kinën ngjanin me ato që Shqipëria kishte me Bashkimit Sovjetik, si kapacitetet e kufizuara të

¹⁰⁶ *AMPJ*, V. 1961, D. 168, B1, fl. 86-90. Radiogram i delegacionit ekonomik të Shqipërisë që shkoi në Kinë dërguar udhëheqjes (Abdyl Këllezi për Enver Hoxhën dhe Mehmet Shehun), më 26 dhjetor 1961.

¹⁰⁷ *Po aty*, V. 1962, D. 171, fl. 9-10. Radiogram i ambasadorit shqiptar në Kinë, Reis Malile dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 17 maj 1962.

¹⁰⁸ *Po aty*, V. 1961, D. 171, fl. 4. Raport i ambasadorit Reis Malile mbi punën e delegacionit tregtar e ekonomik në Kinë kryesuar nga Abdyl Këllezi, 29 janar 1962.

planifikimit, infrastruktura e papërshtatshme portuale dhe studimet e dobëta të fizibilitetit. Në një letër drejtuar Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë pyeste me hidhërim Ministrinë e Tregtisë se “si është e mundur që ne kërkojmë që mallrat të dërgohen me urgjencë nga Kina dhe më pas i lëmë të presin në port për 30 ditë”.¹⁰⁹ Nga ana tjetër, Kina që në qershor të vitit 1960 ngriti tri çështje kryesore me Shqipërinë: transportin midis dy vendeve, i cili mbeti problematik për shkak të distancës dhe mungesës së anijeve të tonazhit të lartë në dispozicion të Shqipërisë, por më e rëndësishmja, kapaciteti i kufizuar për shkarkim mallrash i portit të Durrësit; cilësinë e produkteve shqiptare, në veçanti të naftës, por edhe të disa produkteve industriale të lehta si duhani; çmimi i produkteve nga të dyja anët, me Shqipërinë që kërkonte çmime të larta për produktet e veta dhe çmime më të ulëta për produktet kineze të importuara.¹¹⁰ Për sa i përket transportit detar midis Kinës dhe Shqipërisë, në fund të vitit 1961, të dyja palët ranë dakord të krijonin një “shoqëri të përbashkët” me kontributin fillestar prej dy anijeve mallrash nga secila palë. Shqipëria bleu dy anije mallrash transoqeanike në Itali në valutë të huaj (dollarë amerikanë) që Kina ua siguroi.¹¹¹ Probleme të tjera u shfaqën në zbatimin e projekteve që kërkonin teknologji të cilat Kina ende kishte vështirësi t’i zhvillonte, veçanërisht ato që ishin të nevojshme në industrinë kimike, për nxjerrjen e naftës dhe në disa degë të tjera të industrisë.¹¹² Rieksporti kinez i mallrave bullgare, sovjetike dhe perëndimore në Shqipëri ishte tashmë një shenjë e këtyre mangësive.

Në vitin 1961, qindra ekspertë nga Kina filluan të mbërrinin në Shqipëri “nën terma kontraktualë dhe kushte të mira” për Shqipërinë.¹¹³ Me kushte të mira, regjimi shqiptar nënkuptonte pak ndërveprim jashtë punës midis ekspertëve dhe punëtorëve kinezë dhe homologëve të tyre shqiptarë, më pak pabarazi në paga dhe në përgjithësi më shumë kontroll

¹⁰⁹ *AQSH*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 334, fl. 1-3. Zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Vasil Nathanaili, drejtuar Ministrisë së Tregtisë, 8 shkurt 1960.

¹¹⁰ *Po aty*, F. 503-504/Ministria e Tregtisë, V. 1960, D. 335. Raport i ambasadës shqiptare në Pekin, qershor 1960.

¹¹¹ *AMPJ*, V. 1962, D. 155, fl. 19. Raport mbi takimet e delegacionit ekonomik të Shqipërisë kryesuar nga Abdyl Këllezi, me udhëheqësit e Kinës gjatë muajve dhjetor 1961 dhe janar 1962.

¹¹² *Po aty*, V. 1962, D. 171, fl. 23-26. Raport i ambasadorit Reis Malile, 12 tetor 1962.

¹¹³ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1961, D. 31, fl. 324. Procesverbal i Plenumit të Partisë më 30 qershor dhe 1 korrik 1961.

nga pala shqiptare mbi ekspertizën e ofruar nga Kina. Për më tepër, Kina, duke u treguar e gatshme të ishte e ndryshme nga sovjetikët, fillimisht pagoi për të gjithë specialistët kinezë në Shqipëri dhe gjithashtu për qindra ekspertë dhe studentë shqiptarë gjatë gjithë periudhës së punës apo studimit të tyre në Kinë.¹¹⁴ Në vitet në vijim, numri i ekspertëve kinezë do të arrinte në mijëra, duke qëndruar në Shqipëri deri në verën e vitit 1978 dhe duke ndihmuar në zbatimin e projekteve ekonomike, një pjesë me fizibilitet të diskutueshëm, që i kushtoi Shqipërisë e Kinës miliarda dollarë dhe që formësuan peizazhin ekonomik të Shqipërisë për 30 vitet e mëvonshme.

Përfundime

Paradoksalisht, pikërisht me Kinën e perceptuar si e prapambetur, Shqipëria gjeti mbështetësin më të përshtatshëm ekonomik. Megjithëse Bashkimi Sovjetik dhe vendet e Europës Lindore ishin shumë më të avancuara se Kina, ndihma e tyre erdhi me diktate për sa i përket modelit ekonomik që kërkonte integrim dhe specializim ekonomik brenda ndarjes së punës në KNER, duke e zhvendosur Shqipërinë në një furnizues të mallrave bujqësore. Udhëheqësit shqiptarë e konsideruan këtë një çmim të lartë për të paguar dhe mendonin se ata morën një përfitim të kufizuar nga përparimi ekonomik i partnerëve të tyre. Mes liderëve shqiptarë, një ndjenjë e përgjithshme mosbesimi u rrit ndaj Bashkimit Sovjetik, i cili u perceptua sikur gati po fajësonte Shqipërinë për prapambetjen e saj historike, duke mos ndihmuar mjaftueshëm për të reduktuar hendekun e vendit me pjesën tjetër të vendeve të Europës Lindore. Ata gjithashtu e kuptuan shpejt se, megjithëse Kina ishte shumë prapa bllokut sovjetik europian dhe ende po rindëronte ekonominë e saj dhe vendin pas më shumë se një dekade lufte, Pekini ishte i aftë t'i përgjigjej pozitivisht planeve dhe kërkesave të tyre ekonomike. Në fakt, megjithëse Pekini fillimisht kishte pak kapacitet për të ofruar teknologji të zhvilluara në vend, Kina shpesh ishte në gjendje t'i siguronte ato nga blloku sovjetik. Kështu, transferimi në Shqipëri i teknologjive dhe pajisjeve kineze ishte

¹¹⁴ *AMPJ*, V. 1961, D. 168/2, fl. 24. Mbi ndihmën që jep Kina për Shqipërinë për planin pesëvjeçar 1961-1965, Tiranë, qershor 1961; shih gjithashtu dokumentet e mbledhjes së qeverisë, 16 maj 1961, në *AQSH*, F. 490, V. 1961, D. 24, fl. 3.

në fakt shpesh një ritransferim nga vendet e tjera socialiste dhe ndonjëherë edhe perëndimore.

Pra, aleanca me Kinën solli sintoninë mes motiveve politike dhe dimensioneve ekonomike si në Shqipëri, ashtu edhe në Kinë. Për më tepër, për Shqipërinë, partneriteti i ri me Pekinin kishte avantazhin se paraqiste më pak rreziqe sesa ato që lidheshin me një aleat gjeografikisht më të afërt si Bashkimi Sovjetik, i cili mund të ndërhynte lehtësisht në punët e brendshme të Shqipërisë duke minuar sundimin stalinist të Hoxhës. Për rrjedhojë, vitet 1950 shërbyen për Shqipërinë si një periudhë studimi të sistemit socialist kinez në përgjithësi, i cili u përshtatej më shumë synimeve politike të liderëve shqiptarë. Me gjithë pretendimet publike të Hoxhës për të ndjekur përparimin ekonomik për popullin e tij, ajo që më së shumti i interesonte liderit komunist ishte sundimi i tij (stilit stalinist) dhe qëndrimi në krah të Kinës kishte përfitimin e mbajtjes së paprekur të kultit të tij të personalitetit, sundimin e tij represiv, ndërkohë që ishte në gjendje të ofronte disa përfitime ekonomike (megjithëse të kufizuara) për njerëzit e vendit. Kina, nga ana tjetër, llogariti rëndësinë politike të të pasurit ende një mbështetës europian pasi shumica e vendeve të tjera në Evropën Lindore i kishin reduktuar në minimum marrëdhëniet e tyre me Pekinin për shkak të presionit sovjetik. Kjo shpjegon faktin se si edhe në periudhën 1960-1961, një kohë e tmerrshme për ekonominë e Kinës, Pekini i ofroi Shqipërisë furnizime të konsiderueshme ushqimore dhe ndihma të tjera ekonomike.

Duke marrë parasysh komentet e tyre për Kinën, liderët shqiptarë pa dyshim ishin të vetëdijshëm se lidhja me Kinën kundër Bashkimit Sovjetik, dhe kështu humbja e mbështetjes materiale sovjetike, ishte ekonomikisht e rrezikshme. Por kushtet sovjetike, përveç rreziqeve politike, kufizuan lirinë ekonomike të Shqipërisë në zgjedhjen e rrugës së zhvillimit. Hoxha llogariti se me ndihmën e Kinës do të ndërtonin një model ekonomik të fokusuar në zhvillimin e industrisë, që për ta ishte mishërimi i progresit ekonomik në socializëm. Kina, në fakt, e kishte parë industrializimin si mënyrën për të kompensuar prapambetjen e saj të gjatë ekonomike dhe për të arritur Fuqitë e Mëdha të kohës së saj. Për më tepër, modeli ekonomik i parashikuar nga liderët shqiptarë konsistonte në arritjen e një kapaciteti industrial dhe një niveli zhvillimi bujqësor që do t'i mundësonte Shqipërisë të tregtonte produktet e kësaj industrie të re jo vetëm me Kinën, por edhe me tregjet në Perëndim dhe më gjerë. Në këtë mënyrë, ajo duhej të kompensonte reduktimin e shkëmbimeve me tregun

e Europës Lindore, duke ruajtur autonominë e Tiranës mbi planifikimin ekonomik në një formë që nuk do ta bënte integrimi i mëtejshëm ekonomik me KNER-in. Në vitet që pasuan krijimin e aleancës me Shqipërinë, Kina, megjithatë, ndoshta e detyruar nga mangësitë e veta ekonomike, filloi të shtronte pyetje të fizibilitetit ekonomik për projektet e reja industriale, duke dyshuar se Shqipëria mund të niste një kurs industrializimi të detyruar nga i cili si Bashkimit Sovjetik dy dekada më herët, ashtu edhe Kina së fundmi me Hovin e Madh, kishin vuajtur.

Bibliografi:

- Baeva, Iskra. "Bulgarisch-sowjetische Wirtschaftsbeziehungen nach dem Zweiten Weltkrieg". In Walter M. Iber, and Peter Ruggenthaler (Ed.), M. Iber Walter und Ruggenthaler Peter (Hg.), *Stalins Wirtschaftspolitik an der sowjetischen Peripherie. Ein Überblick auf der Basis sowjetischer und osteuropäischer Quellen*. Innsbruck, Wien, Bozen: Studienverlag, 2011.
- Boriçi, Gjon. *Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze, 1954-1960*. Tiranë: Geer, 2023.
- Boriçi, Gjon. *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë, 1956-1978*. Tiranë: Geer, 2022.
- Boriçi, Gjon. *Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri (nëntor 1944 – dhjetor 1949)*. (Dorëshkrim në proces aprovimi për botim).
- Chao, Kang and Feng-hwa Mah. "A Study of the Rouble-Yuan Exchange Rate". In *The China Quarterly*, No. 17 (Jan. - Mar., 1964).
- Chao, Kang. "Pitfalls in the Use of China's Foreign Trade Statistics". In *The China Quarterly*, No. 19 (Jul. - Sep., 1964).
- Chen, Tao. "East German pragmatism, China's policy of differentiation, and Soviet miscalculation: Hermann Matern's 1961 trip to China revisited". *Cold War History*, vol. 19, no. 1 (2018).
- Crump, Laurien and Simon Godard, "Reassessing Communist International Organisations: A Comparative Analysis of COMECON and the Warsaw Pact in relation to their Cold War Competitors". *Contemporary European History*, Vol. 27 no. 1 (2018).
- Fairbank, John King and Merle Goldman. *China: A New History*. Second Enlarged Edition. New Haven; Harvard University Press, 2006.

- Fitzpatrick, Sheila & Alexander Rabinowitch and Richard Stites (eds.). *Russia in the Era of NEP: Explorations in Soviet Society and Culture*. Bloomington and Indianapolis: Indiana University Press, 1991.
- Gnoinska, Margaret K. "Chipolbrok – Continuity in Times of Change: Sino-Polish Relations during the Cold War, 1949-1969". In Janick Marina Schaufelbuehl, Marco Wyss, Valeria Zanier (eds.), *Europe and China in the Cold War. Exchanges beyond the Bloc Logic and the Sino-Soviet Split*. Leiden and Boston: Brill, 2019.
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. V, Beqir Meta (red. përgj.), grup autorësh, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2023.
- Hoxha, Artan R. *Kisha Ortodokse e Shqipërisë nën Komunizëm (1945-1967)*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2022.
- Jersild, Austin. "Socialist exhibits and Sino-Soviet relations, 1950-60". In *Cold War History*, vol. 18, no. 3 (2018).
- King, Amy. "Reconstructing China: Japanese technicians and industrialization in the early years of the People's Republic of China". In *Modern Asian Studies*, vol. 50, no. 1 (2016).
- Lalaj, Ana. *Pranvera e rrejshme e 1956-s*. Tirana: Infbotues, 2015.
- Li, Danhui and Yafeng Xia, *Mao and the Sino-Soviet Split, 1959-1973. A New History*. New York and London: Lexington Books, 2018.
- Li, Hua-Yu. *Mao and the Economic Stalinization of China, 1948-1953*. Oxford, UK, and New York: Rowman & Littlefield Publishers, 2006.
- Lüthi, Lorenz. *The Sino-Soviet Split. Cold War in the Communist World*. Princeton and Oxford: Princeton University Press, 2008.
- Marku, Ylber. "Communist Relations in Crisis: The End of the Soviet-Albanian Relations, and the Sino-Soviet Split, 1960-61". *The International History Review*, vol. 42, no. 4 (2020).
- Marku, Ylber. "Shifting Alliances: Albania in the Early Cold War". *Journal of Cold War Studies*, vol. 24, no. 3 (2022).
- Marku, Ylber. *Sino-Albanian relations during the Cold War, 1949-1978: An Albanian perspective*, Doctor's thesis, Lingnan University, Hong Kong: 2017. Retrieved from http://commons.ln.edu.hk/his_etd/11/167. (shikuar më 18 tetor 2023).
- Mëhilli, Elidor. "Defying De-Stalinization: Albania's 1956". In *Journal of Cold War Studies*, vol. 13, no. 4 (2011).

- Mëhilli, Elidor. "Globalized Socialism, Nationalized Time: Soviet Films, Albanian Subjects, and Chinese Audiences across the Sino-Soviet Split". In *Slavic Review*, vol. 77, no. 3 (Fall 2018).
- Mëhilli, Elidor. "Socialist Encounters. Albania and the Transnational Eastern Bloc in the 1950s". In *Cold War Crossings. International Travel and Exchange across the Soviet Bloc, 1940s – 1960s*, edited by Patryk Babiracki and Kenyon Zimmer, Introduction by Vladislav Zubok, Arlington, Texas: University of Texas at Arlington, Texas A&M Press, 2014.
- Mëhilli, Elidor. *From Stalin to Mao. Albania and the Socialist World*. Ithaka and London: Cornell University Press, 2017.
- Perović, Jeronim. "The Tito-Stalin Split: A Reassessment in Light of New Evidence". In *Journal of Cold War Studies*, vol. 9, no. 2 (2007).
- Pula, Besnik. *Globalization Under & After Socialism. The Evolution of Transnational Capital in Central and Eastern Europe*. Stanford, CA: Stanford University Press, 2018.
- Roberts, Graham H. (eds.). *Material Culture in Russia and the USSR: Things, Values, Identities*. London and New York: Bloomsbury Academic, 2017.
- Schaufelbuehl, Janick Marina & Marco Wyss, and Valeria Zanier (eds.). *Europe and China in the Cold War. Exchanges Beyond the Bloc Logic and the Sino-Soviet Split*. Leiden, Boston: Brill, 2019.
- Schiavone, Giuseppe. *The Institutions of Comecon*. London and Basingstoke: The Macmillan Press, 1981.
- Schmalzer, Sigrid. "Breeding New Knowledge at Home: The Case of the Albanian Olive Friendship Tree in China". *Chinese Annals of History of Science and Technology*, vol. 3, no. 2 (2019).
- Siegelbaum, Lewis H. *Soviet state and society between revolutions, 1918-1929*. New York, and Cambridge: Cambridge University Press, 1992.
- Suny, Ronald Grigor. *The Soviet Experiment. Russia, the USSR, and the Successor States*. New York and Oxford: Oxford University Press, 2011.
- Shen, Zhihua and Yafeng Xia. "The Great Leap Forward, the People's Commune and the Sino-Soviet Split". *Journal of Contemporary China*, vol. 20, no. 72 (2011).
- Shen, Zhihua and Yafeng Xia. *Mao and the Sino-Soviet Partnership, 1945-1959. A New History*. Lanham, Maryland: Lexington Books, 2015.

Technology Transfer to China. OTA-ISC-340, U.S Congress, Office of Technology Assessment. Washington, DC: U.S. Government Printing Office, July 1987.

Wyczalkowski, Marcin R. "The Soviet Price System and the Ruble". In *International Monetary Fund Staff Papers*, vol. 1, no. 2 (June 1960).

Zofka, Jan. & Péter Vámos & Sören Urbansky (eds.). "Beyond the Kremlin's reach? Eastern Europe and China in the Cold War era", special issue. In *Cold War History*, vol. 18, no. 3 (2018).

YLBER MARKU

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
ylbermarku@protonmail.com

S u m m a r y

PREPARING FOR A PARTNERSHIP: CHINA'S SOCIALIST MODEL AND ALBANIA'S ECONOMIC PATH IN THE EARLY COLD WAR

Based mainly on Albanian primary sources, this article explores the implications of Albania's economic cooperation with China during the late 1950s and the early 1960s. It shows that in Albania's shifting alliances, the role of economic calculations has been as important as that of political convenience. The article argues that China's emphasis on industrialisation, mass mobilisation, and the principle of self-reliance was appealing to Albanian leaders' long term economic plans. This was even more so after the Comecon division of labour left Albania at the margin of the economic integration of the European Soviet bloc, relegating it to an agriculture-based development. The article also argues that although there was no substantial technological transfer between China and Albania during the 1950s, those years served for Albania as a period of study of the Chinese socialist system, which ultimately suited Albanian leaders' political and economic aims more than the Soviet one. Economic relations with China opened new trade routes for Albania, potentially linking Albania's economy with new markets and the international flows of goods. These opportunities, however, remained fully unexploited due to Albania's own economic shortcomings, limited industrial capacity, and poor infrastructure.

